



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**Rishikimi i Vlerësimit Institucional të Institucioneve të
Arsimit të Lartë në Shqipëri**

**Vlerësimi për Akreditimin Periodik Institucional
të Universitetit të Gjirokastrës “Eqrem Çabej”**

Qershor 2021

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Dr. Niko Hyka

Kryetar



2. Profesor Asistent Arben Mehmeti

Anëtar



3. PhD. Gert Guri

Anëtar



Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi	4
Konteksti i këtij vlerësimi	5
Raport i përmbledhur	6
Praktika e mirë	9
Dobësitë	Error! Bookmark not defined.
Rekomandime	Error! Bookmark not defined.
Pohimi i veprimeve të marra	12
Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë të Vlerësimit.....	13
Përmbledhje e gjykimeve	13
Raporti i detajuar	14
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	14
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	19
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula.....	24
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	31
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	39
Lista e Dokumenteve.....	46
Lista A: Lista e dokumenteve	46
List B: Takimet e zhvilluara gjatë vizitës.....	53
List C: Lista e dokumenteve të siguruar gjatë vizitës	53

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë në çfarë shkalle, Instituti i Arsimit të Lartë (IAL) përmbush Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve me përvojë të arsimit të lartë të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-ja, por edhe për të informuar IAL-të, qeverinë shqiptare, publikun dhe studentët se si IAL-ja i përmbush standardet. Gjithashtu, ky raport i ndihmon IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula, Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Në këtë raport identifikohen karakteristikat e praktikave më të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë shkalle IAL-ja përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht, ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL-i i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës (UGJ) u hap në nëntor të vitit 1991, duke përforcuar punën e Institutit të Lartë Pedagogjik, i cili ishte themeluar që në vitin 1971. Me kalimin e viteve, në Gjirokastrë u hapën shumë Degë të Universitetit të Tiranës, si dega e Fakultetit të Ekonomisë e Institutit të Lartë Bujqësor, etj. **[A1, RVV, fq. 7-8]** Më vonë, gjatë viteve, u hapën edhe degë të tjera dhe institucioni është riorganizuar disa herë.

Aktualisht, universiteti ka tre fakultete, 12 departamente dhe 11 njësi administrative. Fakultetin e Shkencave të Natyrës (9 programe), Fakultetin e Ekonomisë, (9 programe), Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, (27 programe) **[AE1.42], [A1, RVV, fq. 10]**. UGJ ofron programe studimi të karakterit profesional, të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë (i pezulluar). Në total ka: 18 programe studimi “Bachelor”, 13 Master të Shkencës, 7 Mastera Profesionale, 6 programe 2-vjeçare profesionale. Të gjitha këto programe janë të njohura në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41.

Misioni i universitetit është të transmetojë, zhvillojë dhe japë njohuri përmes mësimdhënies, kërkimit dhe shërbimeve të tjera për studentët dhe palët e interesuara. **[A1, RVV, fq. 10-12]**

Vizioni i universitetit është të identifikohet si një qendër e rëndësishme kombëtare dhe rajonale për bashkëpunimin akademik, kërkimet dhe veprimtaritë e tjera të AL-së. Gjithashtu, UGJ përqendrohet edhe në trajnimin profesional të specialistëve të lartë që mbulojnë të gjitha fushat e programeve të ofruara të studimit **[AE1.1]**. Grupi i synuar i UGJ-së si universitet rajonal, janë studentët e Shqipërisë Jugore. Universiteti synon që në të ardhshmen të ofrojë diploma të përbashkëta dhe të krijojë një qendër ndërdisiplinore kërkimi dhe zhvillimi, prioriteti i së cilës do të jenë fushat e turizmit kulturor, agro-turizmi, eko-turizmi, etj. Qëllim i kësaj qendre do të jetë rritja e kontributit të UGJ-së në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Shqipërisë Jugore. **[A1, RVV, fq. 12], [AE1], [AE1.33]**

UGJ është i angazhuar në një sërë rrjetesh të njohura akademike dhe ka krijuar marrëdhënie me institucione të tjera arsimore në Shqipëri, si dhe në vende të tjera. Në nivel lokal, UGJ-ja ka vendosur lidhje me një numër të madh shoqërisht anembanë Shqipërisë dhe më gjerë në rajon.

Universiteti ka 252 punonjës, 186 prej të cilëve i përkasin personelit akademik. Në UGJ studiojnë 1489 studentë, (në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore – 506 studentë, në Fakultetin e Ekonomisë 570 studentë, dhe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës 413 studentë) **[AE5.2]**. Rënia e popullsisë në rajonin e Gjirokastrës gjatë viteve të fundit ka pasur ndikim edhe tek universiteti. Për pasojë, numri i studentëve është ulur dhe kjo është një nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballlet ky universitet për momentin.

Raport i përmbledhur

Universiteti “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë është një institucion publik i arsimit të lartë, që ndodhet në qytetin e Gjirokastrës në rajonin jugor të Shqipërisë. Gjirokastra është një qytet shumë i rëndësishëm për historinë dhe kulturën e tij. Krahas uljes së vazhdueshme të popullsisë gjatë viteve, ai mbetet një nga qytetet më të rëndësishme jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të kulturës globale, pasi ai është pjesë e Programit të Trashëgimisë të UNESCO-s.

Universiteti ka qenë pjesë përbërëse e Gjirokastrës që prej vitit 1971 dhe ka luajtur vazhdimisht një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qytetit¹. Pjesa dërmuese e studentëve dhe të diplomuarve nga ky universitet janë nga rajoni i Gjirokastrës, gjë e cila e bën atë ofruesin kryesor të arsimit universitar dhe trajnimit profesional.

Universiteti bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera lokale qeveritare, bizneset në rajon për promovimin e përparësive që ka ky rajon. Ai ka një bashkëpunim shumë të ngushtë edhe me Universitetin e Janinës në Greqi, për të sjellë përfitime jo vetëm të ndërsjella për të dyja palët, por edhe për pakicën greke që jeton në Shqipëri. Kjo gjë, si dhe përfshirja në listën e UNESCO-s e kanë përforcuar më tej punën e rëndësishme që po kryhet në fushën e trashëgimisë kulturore, ku universiteti luan një rol qendror.

Universiteti është i organizuar në 3 fakultete dhe ofron 44 programe studimi në tre cikle për të gjitha fakultetet dhe përdor Sistemin Evropian të Transferimit të (ECTS).

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional i Universitetit për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së Standardeve Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Në raportin e vlerësimit të parë të përgatitur në Maj të vitit 2017, u identifikuan 5 karakteristika të praktikës së mirë, dhe Universitetit iu dhanë 3 rekomandime për të gjetur një zgjidhje për fushat e identifikuara të tre dobësive.

Bazuar në raportin² e parë të akreditimit të UGj-ës, gjykimet e përmbledhura për secilën Fushë Vlerësimi, ishin si më poshtë:

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij, **janë përmbushur kryesisht.**
- 2 Standardet për Burimet. **janë përmbushën kryesisht.**
- 3 Standardet për Kurrikulën, **janë përmbushën kryesisht.**
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin, **janë përmbushën kryesisht.**
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandoi Bordit të Akreditimit (BA) se në Universitetin e Gjirokastrës, Standardet Shtetërore të Cilësisë ishin përmbushur kryesisht dhe për pasojë, Bordi i dha akreditimin Universitetit të Gjirokastrës për një periudhë 3 vjeçare përmes Vendimit Nr. 67, datë 21.09.2017³. Sipas këtij vendimi, institucionet janë të detyruara të paraqesin brenda gjashtë muajve një plan masash për përmbushjen e pesë rekomandimeve të dhëna.

Institucioni vuri në dispozicion informacione për tre rekomandimet **[A1, RVV, fq. 5-6]** e dhëna nga grupi i vlerësimit të jashtëm, por nuk ishte marrë ende me trajtimin e rekomandimeve të lëna në vendimin e BA-it.

¹ <https://uogj.edu.al/>

² www.ascal.al/media/documents/qaa%20eer/University%20of%20Gjirokastra%20EER%20AL.pdf

³ <https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-21-22-shtator-2017>

1. [Raporti i grupit të vlerësimit] – Universiteti duhet të krijojë dhe të vërë në zbatim një sistem, për mundësimin e analizës së punësimit të lartë me qëllim për të regjistruar informacionet e duhura për projektimin dhe zhvillimin e programit (në proces)
2. [Raporti i grupit të vlerësimit] – Universiteti duhet të marrë masa që të përdorë teknologjinë e informacionit për sigurimin e programeve të tij (trajtuar plotësisht)
3. [Raporti i grupit të vlerësimit] – Universiteti duhet të hartojë një strategji institucionale, në të cilën do të identifikohen dhe mbështeten përparësitë (në proces)
4. [Vendimi i BA-së] – Në kuadër të zhvillimit të strategjisë institucionale bazuar në misionin dhe objektivat e universitetit, promovimi dhe rritja e nivelit të personelit akademik duhet të bazohet në kritere dhe standarde, të cilat bëjnë të mundur promovimin e vërtetë bazuar te standardet; (në proces)
5. [Vendimi i BA-së] – Universiteti i Gjirokastrës duhet të rrisë mbështetjen financiare për të bërë investime në bibliotekën e institucionit, me qëllim për të rritur fondin e librave shkencorë, teksteve bashkëkohore dhe bibliotekës online (trajtuar plotësisht).

Ekipi i ekspertëve të jashtëm gjykojnë se institucioni i ka përmbushur rekomandimet 2, 3, 5 të lëna gjatë akreditimit të parë. Janë bërë ca përparime për të gjetur një zgjidhje për dobësitë 1 & 4 të përcaktuara në Vendimin e Bordit të Akreditimit (Vendimi 67), por gjithsesi grupi i vlerësimit të jashtëm i identifikoi ende këto dobësi.

Raporti i Vetëvlerësimit u përgatit nga një grup i brendshëm vetëvlerësimi, që përbëhej nga gjashtë përfaqësues të universitetit me njohuri të mira për Universitetin, duke përfshirë edhe një përfaqësues të trupës studentore **[AE1.30]**. Faza e vlerësimit që do të kryhej në tryeza, u zhvillua gjatë një periudhe shumë të vështirë të pandemisë Covid 19. Kryerja e vetëvlerësimit u bazua në dokumente të brendshme, statutet dhe rregulloret e Universitetit, të shoqëruara me të dhënat dhe raportet përkatëse statistikore. Projekt raportet iu shpërndanë një audience më të gjerë brenda institucionit përpara përfundimit. Senati Akademik autorizoi lëshimin e raportit përfundimtar dhe dorëzimin e tij pranë ASCAL-it.

Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhej nga tre anëtarë, dy prej të cilëve ishin nga jashtë Shqipërisë dhe një anëtar i personelit të një institucioni shqiptar. Grupi i vlerësimit të jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit të caktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupit të vlerësimit të jashtëm iu vu në dispozicion gjatë takimeve Raporti i Vetëvlerësimit, dosja me dokumentet mbështetëse dhe dokumentet e kërkuara shtesë.

Për shkak të kufizimeve të vendosura për pandeminë Covid 19, vizita e vlerësimit u zhvillua në mënyrë virtuale (Mbledhje Virtuale) përgjatë dy ditëve, në datat 26 dhe 27 prill të vitit 2021. Më 28 prill të vitit 2021, anëtari shqiptar i grupit të vlerësimit të jashtëm, Drejtori i ASCAL-it dhe Menaxheri i Vlerësimit të këtij procesi, bënë një vizitë në institucion për të parë infrastrukturën, laboratorët dhe hapësirat e tjera të UGJ-së.

Falë larmisë së madhe të informacioneve mbështetëse të vëna në dispozicion nga Universiteti, grupi i vlerësimit pati mundësinë të njëjhej me strukturën, politikën, procedurat e drejtimit, si dhe me mënyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Këto dokumente përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike,

raportet e brendshme, raportin vjetor dorëzuar pranë Ministrisë, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumëve, shembujt e informimit rreth programeve, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë mbledhjeve dy-ditore së vlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerë të jashtëm dhe punëdhënës. Diskutimi mbështetej në sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Gjatë të gjitha mbledhjeve u mbajtën shënime, të cilat janë pasqyruar në këtë raport.

Për shkak të pandemisë Covid 19, grupi i vlerësimit të jashtëm i njëj vështirësitë me të cilat është përballur universiteti për këtë vlerësim dhe vlerëson nivelin e angazhimit të Universitetit në këtë proces, si dhe bashkëpunimin që iu ofrua grupit të vlerësimit të jashtëm në të gjitha fazat e këtij procesi. Grupi i vlerësimit të jashtëm lavdëron në mënyrë të veçantë, punën e Grupit të Vetëvlerësimit, i cili ofroi dokumentacione gjithëpërfshirëse të bazuara në fakte, informacione, personelin akademik, si dhe studentët që morën pjesë në takime.

Grupi i vlerësimit të jashtëm falënderon ASCAL-in, Menaxherin e Vlerësimit dhe drejtorin për mbështetjen e këtij procesi. Grupi i Vlerësimit të jashtëm përbëhej nga Niko Hyka (Kryetar), Arben Mehmeti dhe Gert Guri (Anëtarë të Jashtëm).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e mëposhtme:

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin janë **përbushur plotësisht**. Për të arritur në këtë përfundim, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikon dy praktika të mira, një pohim dhe një rekomandim. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se Universiteti drejtohet me efikasitet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statusin dhe Rregulloret e Universitetit, si dhe ka bashkëpunime të mira me institucionet rajonale. Ka një problem lidhur me informacionet e kufizuara që zotërojnë përfaqësuesit e trupës studentore në senatin akademik. Në i kuptojmë vështirësitë me të cilat janë përballur studentët për të ndjekur këto takime gjatë pandemisë, si dhe kohën e shkurtër që nga zgjedhja e tyre në senatin akademik.

Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**. Grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në këtë përfundim, pasi ai nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, identifikoi dy dobësi, dha dy rekomandime përkatëse dhe bëri dy pohime. Një shembull i mirë është raporti i personelit / studentëve, i cili është sa rreth 1/10 e disa programeve të studimit. Shkaku i kësaj është kryesisht numri i pakët i studentëve në këto programe. Dobësitë lidhen me faktin se UGJ ka vështirësi në rekrutimin e personelit tepër të kualifikuar akademik. Kjo ndikon në strategjinë për promovimin e personelit akademik lidhur me titujt e fituar akademikë. Kësisoj, grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon se Universiteti duhet të identifikojë dhe të zbatojë një strategji për rritjen e cilësisë së personelit akademik dhe përmirësimin e sistemit të vlerësimit të performancës së personelit. Pohimet janë bërë lidhur me masat e marra nga institucioni për zbatimin e sistemit për mësimdhënien online dhe ngritjen e një laboratorit të ri për arkeologjinë.

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**. Grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në këtë përfundim pasi identifikoi katër karakteristika të praktikës së mirë, pesë dobësi dhe rekomandimet përkatëse, ndërkohë që bëri edhe një pohim. Karakteristika e praktikës së mirë lidhet me sistemin e edukimit LLL (të mësimnxënies së përhershme), si dhe bëri

edhe një pohim. Karakteristika e praktikës së mirë lidhet me sistemin e edukimit LLL, bashkëpunimin me institucionet për trajnime praktike, përmirësimin e programeve, etj. Shqetësimet lidhen me përmbajtjen e programeve Bachelor të shkallës shkencore në Fakultetin e Ekonomisë, numrin e vogël dhe cilësinë e studentëve, orët e pakta të praktikës, procedurën e marrjes së sugjerimeve nga ana e studentëve dhe personave të interesuar për përmirësimin e kurrikulës, etj. Rekomandimet e dhëna përkatësisht janë rishikimi i përmbajtjes së programit në degën e ekonomisë, zhvillimi dhe përmirësimi i orientimit praktik të programeve, monitorimi i punësimit të studentëve, hapat specifikë strategjikë për rekrutimin e studentëve, etj.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**. Grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në këtë përfundim pasi identifikoi dy dobësi, dha rekomandimet përkatëse, si dhe bëri tre pohime. Dobësitë lidhen me mungesën e projekteve kërkimore dhe pajisjeve laboratorike, buxhetin e vogël në nivel departamenti. Rekomandimet përkatëse përqendrohen në mënyrën si institucioni rrit buxhetin përkatëse kërkimor dhe krijon një sistem për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit që kanë rezultatet kërkimore. Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon se Universiteti ka bërë përpertime për sa i përket numrit të trajnimeve mësimdhënëse dhe duhet të vazhdojë të ecë kështu.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**. Grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në këtë përfundim pasi nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe bëri një pohim. Grupi i vlerësimit të jashtëm pohon se përpertime i bërë për sa i përket dixhitalizimit të bibliotekës, do t'i ndihmojë studentët me studimet e tyre. Gjithashtu, grupi i vlerësimit të jashtëm bëri disa sugjerime lidhur me rregulloren e studentëve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për plagjiaturën.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- UGJ bashkëpunon me institucionet lokale publike dhe private për të mbështetur studentët gjatë praktikës së tyre, e cila është çelësi për punësimin e tyre në të ardhmen. Ky universiteti ka arritur gjithashtu të ketë bashkëpunime ndërkombëtare në disa fusha të veçanta, si në degën e gjuhës dhe letërsisë greke dhe Albanologjisë (**Kapitulli III Standardi III.3**)
- Edukimi LLL nisi nga një projekt i suksesshëm për trajnimin e mësuesve, një pikënisje shumë e mirë për të ngritur një qendër LLL plotësisht funksionale (**Kapitulli I Standardi I.2**)
- Në faqen zyrtare të internetit ofrohen *syllabi* për çdo program studimi, gjë e cila u ofron mundësinë studentëve dhe studentëve të ardhshëm të kenë akses të shpejtë në informacionet përkatëse. (**Kapitulli I Standardi I.6**).
- UGJ organizon në bashkëpunim me zyrën e punës trajnime për studentët, të cilat janë të mbështetura financiarisht (**Kapitulli I Standardi I.11**)

- Kurrikula në disa departamente si studimet e mësimdhënies janë përmirësuar deri në 80% falë komenteve të dhëna nga studentët dhe palët e interesuara. Programet e reja, si programi i ciklit të dytë në degën e infermierisë, janë krijuar gjithashtu në përgjigje të nevojave të tregut. Kjo përvojë duhet të shtrihet edhe në departamente të tjera, (lutemi, shikoni rekomandimet e mëposhtme). **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Sigurimi i mbikëqyrësve individualë për studentët e ciklit të parë, me qëllim për të lehtësuar ecurinë e tyre përmes programit që ndjekin. **(Kapitulli I, Standardi III.6).**

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Angazhimi jo i duhur nga ana e institucionit për të rekrutuar personel akademik me kualifikime të larta. **(Kapitulli III, Standardi II.2)**
- Pamjaftueshmëria e mekanizmave për vlerësimin e performancës së veprimtarisë së personelit akademik. **(Kapitulli III Standardi IV.3)**
- Kurrikula e tre programeve të studimit bachelor në Fakultetin e Ekonomisë është e njëjtë në dy vitet e para dhe specializimi është i përqendruar vetëm në vitin e tretë. Pavarësisht koncepteve të ndara, kjo ngjashmëri e zvogëlon impaktin e specializimit për programet përkatëse të studimit. **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Qasja aktuale për rekrutimin e studentëve nuk është e mjaftueshme për të balancuar rezultatin e ndryshimeve demografike në zonë. Numri i vogël i studentëve kufizon të ardhurat financiare të gjeneruara nga tarifat studentore, si dhe kapacitetin kërkimor dhe të ndërkombëtarizimit të UGJ-së. **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore përqendrohet zakonisht te pyetësorët dhe puna në terren, por jo në plotësimin e dokumenteve ose të projekteve **(Kapitulli I Standardi I.11)**
- Mungesa e mekanizmave të identifikimit për mundësitë e stazhit të punës, i cili kryhet kryesisht falë pedagogëve **(Kapitulli I Standardi I.9).**
- Të dhënat e kufizuara për profilet e studentëve të punësuar kufizojnë cilësinë e sugjerimeve lidhur me mënyrën e përmirësimit të programeve studimore bazuar në nevojat e tregut **(Kapitulli I Standard I.10)**
- Mungesa e projekteve kërkimore dhe pajisjeve laboratorike për kërkime, të cilat bëjnë të mundur botimin e eseve në gazeta, e cila shoqërohet me një faktor ndikimi. **(Kapitulli I Standardi II.4)**
- Buxheti për projektet e vogla kërkimore përdoret shumë pak. Zakonisht përdoret për veprimtaritë e zakonshme në nivel departamenti (pjesëmarrjen në konferenca, bashkë-financimin e disa projekteve). Mungon një rregullore për shpërndarjen e duhur të fondeve për kërkime. Universiteti duhet të gjejë mënyra më të mira e më të përshtatshme për shpërndarjen e fondeve të kërkimeve. **(Kapitulli II Standardi I.1)**

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti duhet të marrë në konsideratë hartimin e një strategjie për rekrutimin e personelit akademik dhe zhvillimin e mekanizmave të stimujve për punësimin në universitet të një personeli të kualifikuar **(Kapitulli III, Standardi IV.1)**
- Institucioni duhet të përqendrohet në zhvillimin e sistemit të sigurimit të cilësisë së brendshme, pjesë e të cilit duhet të jetë edhe vlerësimi i performancës së veprimtarisë së personelit akademik. **(Kapitulli III Standardi IV.3)**
- Të bëhet një dallim më i mirë i kurrikulave të programeve të studimit në dy vitet e para të nivelit Bachelor në Fakultetin e Ekonomisë, duke pasur parasysh edhe përvojën e universiteteve të tjera. Të merret në konsideratë një qasje për harmonizimin e të gjitha sugjerimeve të marra për të përmirësuar kurrikulën në tre shtylla kryesore: 1) komentet e studentëve në fund të çdo kursi; 2) sugjerimet e palëve të interesuara lidhur me aftësitë e nevojshme që u mungojnë studentëve; 3) rezultatet e kërkimit të kryer nga profesorët në fushën specifike të kursit. **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Një strategji afatshkurtër ose afatmesme se si të rritet numri i studentëve. Në strategjinë aktuale nuk ka asnjë masë specifike për zgjidhjen e këtij problemi. **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Rritja e angazhimit të studentëve në kërkime, veçanërisht të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, duke përdorur projektet ndërkombëtare ose punën në terren. **(Kapitulli I Standardi I.11)**
- UGJ duhet të institucionalizojë zhvillimin e praktikave të studentëve përmes krijimit të mekanizmave me qëllim për të lehtësuar identifikimin e stazheve të mundshme të punës për studentët.
- Zbatimi i rekomandimeve të dhëna gjatë akreditimit të mëparshëm institucional monitoron dhe zbërthen të dhënat për studentët e punësuar, për identifikimin e profileve të kërkuara nga tregu, me qëllim për t'i përmirësuar programet e studimit sipas rastit. **(Kapitulli I Standardi I.10)**
- Studiuesit e vjetër dhe veçanërisht ata të rinj duhet të mbështeten dhe të angazhohen më tepër në veprimtaritë kërkimore nga stafi i vjetër, si dhe të vendoset një standard ku të përcaktohet botimi i të paktën një eseje në vit. **(Kapitulli I Standardi II.6 dhe Kapitulli I Standardi II.7)**
- Pritet që të bëhet një ndarje e buxhetit specifik dhe të jepen stimuj përkatës për zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. **(Kapitulli I Standardi II.6)**
- Institucioni duhet të gjejë mënyra alternative për të rritur numrin e studentëve dhe për t'i pasqyruar ato në Strategjinë për vitet 2021-2025. **(Kapitulli III Standardi I.5)**
- Treguesit kyç të performancës duhet të përfshihen në RVV. Duke nisur nga studentët e rinj të regjistruar, numri total i studentëve, numri i studentëve të larguar, numri i diplomimeve, informacionet kryesore për buxhetin, listën e botimeve, numrin e botimeve për çdo profesor, listën e projekteve të financuara në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. **(Kapitulli I Standardi II.1)**
- Personeli duhet të reflektojë bazuar në pyetësorët e studentëve si dhe të përmirësojë performancën e tij, bazuar në kërkesat e trupës studentore të paraqitura në pyetësorë. **(Kapitulli I Standardi II.3)**
- UGJ duhet të rrisë aplikimet për projektet kërkimore nga kërkesat kombëtare, si dhe të rrisë numrin e projekteve ndërkombëtare kërkimore. **(Kapitulli II Standardi I.1)**

- Qendra Ndërdisciplinore për Kërkimin dhe Zhvillimin Shkencor është në fazën fillestare të konsolidimit, por puna duhet të intensifikohet, me qëllim për të nisur aktivitetin dhe stafi i ri duhet të trajnohet për përdorimin e pajisjeve të duhura. **(Kapitulli II Standardi II.6)**
- UGJ duhet të organizojë në të ardhmen e afërt seminare për personelin me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin për plagjiaturën. **(Kapitulli I Standardi II.8)**
- Proceset e konsultimit mes profesorëve dhe studentëve duhet të monitorohen për të siguruar numrin e studentëve që kërkojnë asistencë na bazë javore ose mujore, kohën që çdo profesor harxhon në konsultim me studentët, si dhe rezultatin përfundimtar që ky konsultim ka në performancën e studentëve. **(Kapitulli I Standardi III.1)**
- Duhet të hartohet Rregullorja Alumni, me qëllim për të përforcuar bashkëpunimin me Alumni përmes takimeve zyrtare të organizuara nga sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore-Sportive. **(Kapitulli I Standardi III.3)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi se institucioni po punon për hartimin e një strategjie, e cila do të trajtojë më mirë nevojat aktuale, si rolin e UGJ-së si një faktor kyç për zhvillimin lokal dhe veprimet që do ndërmerren për përmirësimin e rekrutimit të studentëve. **(Kapitulli III Standardi I.5)**
- Gjatë vitit të fundit është rritur përdorimi i teknologjisë së informacionit në veprimtari të ndryshme **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**
- Laboratori i ri arkeologjik do të rrisë pjesëmarrjen e studentëve në studime dhe kërkime, si dhe do ta ndihmojë universitetin t'u ofrojë shërbime edhe institucioneve të tjera **(Kapitulli III, Standardi VII.2)**
- Strategjia e Universitetit do të përmirësohet për të pasqyruar më mirë nevojat aktuale që ka UGJ, veçanërisht numrin e vogël të studentëve. **(Kapitulli I, Standardi I.10) M1.**
- Hapat që ndiqen nga Universiteti për të bërë shpërndarjen e shumës prej 3.5 milion Lek për projekte të vogla kërkimore, të cilat mund të dorëzohen nga personeli i departamenteve. Gjithsesi, një rregullore duhet të hartohet për këto projekte dhe të gjithë studiuesit duhet të vihen në dijeni për këtë mundësi. **(Kapitulli II Standardi I.1)**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm ka vërejtur se numri i trajnimeve mësimdhënëse nuk është i madh, pavarësisht nevojave të mësuesve për të mësuar metodat e reja të mësimdhënies; dhe pavarësisht faktit që UGJ ka organizuar një sërë trajnimesh përmes projekteve të ndryshme. Gjithashtu, UGJ duhet të gjejë mekanizimin (krijimi i Qendrës së Ekselencës) që përmes vlerësimit vjetor të stafit dhe aplikimit për gradat akademike, këto trajnime të bëhen të detyrueshme në të ardhmen. **(Kapitulli I Standardi II.4)**
- UGJ po mundohet të forcojë bashkëpunimin shkencor mes Qendrës Ndërdisciplinore për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor dhe Departamenteve. **(Kapitulli I Standardi II.6).**

- Janë ndërmarrë hapa për të dixhitalizuar dhe pasuruar bibliotekën përmes buxhetit të Universitetit dhe donacioneve, me qëllim për të mbështetur mësimnxënien dhe kërkimet e studentëve. **(Kapitulli I Standardi III.5)**

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht.**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Gjykimi i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë e kryen punën e tij akademike dhe shkencore/kërkimore në përputhje me kuadrin përkatës ligjor. Këto veprimtari bazohen në aktet ligjore kombëtare në fuqi, statutin e universitetin dhe procedurat dhe aktet plotësuese normative të miratuara nga organet dhe autoritetet drejtuese të UGJ-së. Ai është një institucion i lartë publik i krijuar më 12/11/1991. **[RVV p7]** Statuti i UGJ-së është dokumenti më i lartë, në të cilin parashikohet kuadri rregullator i normave dhe rregullave për të siguruar zbatimin e duhur të veprimtarive në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat e UGJ-së. Statuti është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80\2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 38. Në përputhje me Ligjin Nr. 80\2015, Statuti i ndryshuar i UGJ-së u miratua bazuar në Vendimin e Senatit Nr. 33, datë 20.12.2016. **[AE1.2]** Në një linjë me Rregulloren e UGJ-së **[AE1.5]** të miratuar nga Senati me vendim numër 7 (19/05/2011) dhe të ndryshuar po me Vendim të Senatit Numër 26 (08/09/2020), Statuti rregullon veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimore dhe administrative të Universitetit, në përputhje me misionin dhe objektivat përkatëse, ndërkohë që rregullon edhe veprimtarinë e të gjitha strukturave drejtuese. **[BM2, RVV p13] (Kapitulli III Standardi I.1)**
- 1.2 Organet dhe autoritetet kolegjiale drejtuese garantojnë organizimin dhe administrimin e UGJ-së duke e zhvilluar veprimtarinë e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Organet më të larta vendimmarrëse janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, të cilët sigurojnë administrimin e veprimtarisë akademike dhe financiare të universitetit. **[AE1.1, AE1.4, AE1.12, AE1.13, AE1.22]** Senati Akademik është organi më i lartë kolegjial vendimmarrës i UGJ-së, i cili vendos për planifikimin strategjik kryesor të institucionit lidhur me fushat e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe sigurimit të cilësisë. Ai jep miratimin e tij për çështje administrative dhe financiare. Ky organ funksionon në përputhje me Statutin e UGJ-së, në të cilin parashikohen të gjitha kompetencat e tij. **[AE1.1]**. Senati mbledhet në mënyrë periodike, zakonisht çdo muaj, dhe merr vendimet përkatëse. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjial vendimmarrës lidhur me menaxhimin administrativ, financiar dhe të aseteve të UGJ-së **[AE1.1]** Bordi i Administrimit funksionon bazuar në Rregulloren e tij, mbledhet në mënyrë periodike dhe merr vendimet përkatëse **[AE1.1, AE1.22]**. **(Kapitulli III Standardi I.2)**
- 1.3 Organet kolegjiale të UGJ-së, mbledhen në mënyrë periodike, në përputhje me dispozitat dhe normat specifike që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Nëse është e nevojshme, këto organe mund të organizojnë edhe më shumë mbledhje **[BM1]**. Senati, si organi më i lartë kolegjial akademik i Universitetit e zhvillon veprimtarinë e tij duke organizuar mbledhje në mënyrë të rregullt **[AE1.12, BM2] [RVV p15]**. Senati Akademik i vë në zbatim funksionet e tij në bashkëpunim me organe të tjera kolegjiale të UGJ-së, si me Bordin e Administrimit, Rektoratin, Këshillin e Etikës dhe Komisionet e Përhershme **[RVV p13]**. Ata bashkëveprojnë si autoritetet drejtuese të UGJ-së në përputhje me kuadrin

ligjor në fuqi dhe statutin dhe rregulloren e miratuar të Universitetit, me qëllim për të hartuar dhe zbatuar planifikimin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë për mësimdhënien, zhvillimin kërkimor, buxhetin, etj. **[AE1.1 AE1.12, BM2]**. Bordi i Administrimit është përgjegjës për administrimin financiar të institucionit, për përcaktimin e kriterëve për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore. Ai bashkëpunon me Senatin Akademik për përgatitjen dhe miratimin e buxhetit vjetor dhe buxhetit afatmesëm bazuar në propozimet e bëra nga njësitë kryesore dhe të bazës, planin strategjik për zhvillimin institucional dhe programin për buxhetin afatmesëm **[AE1.1, AE1.12, AE1.22, BM2]**. Rektorati përgatit Planin Strategjik të UGJ-së bazuar në nevojat/propozimet e Njësive Akademike, i cili miratohet më pas nga Senati. Ai është gjithashtu përgjegjës për shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore mes Njësive të ndryshme Akademike **[RVV fq. 14]**. Nga ana tjetër, Këshilli i Etikës përqendrohet në çështje që kanë lidhje me veprimtarinë etike të UGJ-së **[AE1.23, AE1.24]**. Dekanati është institucioni ndërlidhjes mes Rektoratit dhe Njësive Bazë. Ajo miraton përparësitë e identifikuar nga njësitë e bazës lidhur me programet e studimit, kriteret e pranimit dhe përparësitë e zhvillimit **[AE1.1 RVV fq. 15]**. Vendimet e marra nga organet kolegjiale (Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Dekanati) protokollohen dhe përcillen te strukturat përkatëse për zbatimin e tyre në përputhje me qëllimin e vendimit **[BM3]**. Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të profesorëve me kohë të plotë, UGJ nuk e ka krijuar ende Këshillin e Profesorëve. Studentët kontribuojnë në debate konstruktive falë pjesëmarrjes së tyre në Senat dhe Këshillin e Përhershëm të Marrëdhënieve të Studentëve **[AE1.1 RVV fq. 15]**. Duke qenë njësi bazë, mbledhjet e Departamenteve përqendrohen në çështje që kanë të bëjnë me detyrat e mësimdhënies, programin e studimit, monitorimin e veprimtarive kërkimore e shkencore të ndërmarra nga anëtarët e departamentit, si dhe aspektet e marrëdhënieve me studentët trajtohen në diskutimet e zhvilluara me personelin akademik, falë përfaqësuesve të trupës studentore në Senat dhe mbledhjet e Departamentit. Mbledhjet e departamenteve drejtohen nga drejtuesi i departamentit **[AE1.6, AE1.7, AE1.8, AE1.9, BM3, BM8]**. **(Kapitulli III Standardi I.3)**

1.4 Universiteti i Gjirokastrës e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, mbi bazën e të cilit janë hartuar edhe aktet e brendshme në fuqi, me qëllim për të siguruar autonominë e jashtme dhe të brendshme të institucionit **[BM8]**. Statuti dhe Rregullorja e UGJ-së, në të cilat është parashikuar kuadri rregullator organizativ dhe funksional i institucionit, si dhe vlerësimet periodike institucionale, garantojnë autonominë e brendshme **[AE1.1]**. Një nga mekanizmat e ngritur për të siguruar dhe garantuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm është Njësia e Brendshme e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, e cila është një komitet i përhershëm brenda strukturës së UGJ-së. **[AE1.1, Neni 16]**.

Autonomia financiare sigurohet përmes të ardhurave të gjeneruara nga veprimtaria e universitetit, mbështetja financiare nga shteti dhe pjesëmarrja në projektet e financuara nga BE (dhe jo vetëm) **[AE1.15, AE1.15.1, AE1.34]**.

Autonomia akademike konsiston në lirinë për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përkufizuar fushat e veprimtarisë kërkimore, ndërsa promovimi bazohet në vlerësimin e veprimtarisë shkencore dhe atë të mësimdhënies **[AE1.21, AE1.38]**.

Autonomia organizative lidhet me aftësinë e universitetit për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organet dhe strukturat drejtuese, si dhe për të rregulluar ushtrimin e

veprimtarive të tyre bazuar në kuadrin e brendshëm ligjor të hartuar në përputhje me ligjet në fuqi **[AE1.27]**.

Gjithsesi, UGJ nuk ka autonomi financiare në nivel departamenti, siç parashikohet edhe në Ligjin për arsimin e lartë. **[BM8] (Kapitulli III Standardi I.4)**

1.5 Në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe për përmbushjen e detyrimeve të tij, UGJ ka hartuar një strategji për zhvillimin institucional për periudhën 2020-2025 **[SER p17]**. Në Strategjinë e Zhvillimit përcaktohen skenarët kyçë të zhvillimit institucional që kërkojnë të zhvillohen më tej, si: mësimdhënia dhe mësimnxënia, kërkimi, dinjiteti shoqëror, ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti, rekrutimi i personelit dhe infrastruktura. Në përgjithësi, skenarët, mekanizmat dhe veprimet konkrete për arritjen e këtyre objektivave strategjikë, në përputhje me vizionin dhe platformën e zhvillimit të UGJ-së dhe burimet e saj të financimit, janë parashikuar në dokumentin e strategjisë, por nuk i është dhënë ende një fokus të veçantë rekrutimit të studentëve, i cili mbetet një çështje kyçe. **[AE1.33] (Kapitulli III Standardi I.5)**

1.6 Në përputhje me nenin 32 të Ligjit Nr. 80/2015, UGJ përgatit për çdo vit akademik raportin vjetor, i cili dorëzohet pranë MASR-së dhe publikohet në faqen zyrtare të universitetit. Përmes këtij raporti vjetor, MASR informohet mbi aktivitetin akademik, gjendjen financiare, parashikimin e angazhimit të personelit akademik, jep një vlerësim të përgjithshëm të cilësisë së studentëve dhe programeve të studimit, si dhe tarifat e shkollimit për vitet në vijim **[AE1.41]**. Raporti vjetor bazohet në të dhënat e dorëzuara periodikisht nga njësitë akademike, si dhe në vlerësimin e jashtëm/të brendshëm për të vlerësuar efikasitetin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në UGJ në përputhje me objektivat e rëna dakord dhe standardet e përcaktuara. Ky dokument diskutohet dhe miratohet nga Senati, Rektorati dhe Bordi i Administrimit me përfshirjen e të gjithë palëve të tjera të interesuara pjesëmarrëse. **[RVV p17]**. Ky raport u prezantua nga Rektorati gjatë mbledhjes së Senatit Akademik dhe u bë objekt diskutimi mes personelit akademik e administrativ, dhe studentëve **[BM2, BM9]**. Gjetjet e raportit përdoren nga Rektorati për të marrë masa për trajtimin e sfidave të evidentuara në aspektin institucional apo specifik, si dhe për të identifikuar strukturat përgjegjëse për përmbushjen e tyre. **[BM11]. (Kapitulli III Standardi I.6)**

UGJ, duke u mbështetur në misionin e tij për të ofruar mundësinë e arsimit të lartë, si dhe për të zhvilluar gjithnjë e më shumë kapacitetet e të nxënësve gjatë gjithë jetës duke integruar kërkimin, mësimdhënien dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, ka përvetësuar një organizim, i cili siç përmendet në seksionin 1.4 mundëson lirinë akademike, autonominë financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. UGJ është e organizuar në njësi kryesore (fakultete), njësi bazë (departamente) dhe njësi mbështetëse. **[AE1.1]** Organizimi i UGJ-së është në përputhje me kuadrin ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr. 80/2015 dhe për të përmirësuar misionin dhe objektivat e institucionit. UGJ përbëhet nga tre njësi kryesore, përkatësisht Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave (6 njësi bazë), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (3 njësi bazë), Fakulteti i Ekonomisë (3 njësi bazë). **[RVV p 8-10]**.

UGJ ka gjithashtu faqen e tij të internetit, në të cilën ofrohet një përmbledhje e programeve të disponueshme të studimit, kërkimit akademik, informacionit për personelin akademik, raporteve të mbledhjeve të rektoratit, vendimeve të Senatit

Akademik, vendimeve të Bordit të Administrimit, projekteve, mundësive të mobilitetit, etj.⁴, **(Kapitulli III Standardi II.1)**

- 1.7 Për sa i përket vendimmarrjes, organet kolegjiale të UGJ-së janë të organizuara në nivel institucional dhe njësi kryesore. Organet kolegjiale janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Asambleja e Personelit Akademik, Komisionet, Këshilli i Etikës, Rektorati dhe Dekanati **[AE1.1 AE1.54]**. Këto organe funksionojnë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe këto organe janë përgjegjëse për marrjen e vendimeve apo dhënien e rekomandimeve për veprimtarinë e UGJ-së, njësive kryesore (fakulteteve) dhe njësive bazë (departamentet), sipas dispozitave të statutit dhe rregulloreve. **[AE1.1, SER p19] (Kapitulli III Standardi II.3)**
- 1.8 UGJ ka krijuar zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni për monitorimin e shkallës së punësimit të të diplomuarve të tij dhe ruajtjen e kontakteve me ta për të kuptuar shkallën e përputhjes midis kurrikulës akademike dhe nevojave të tregut të punës. Një bazë të dhënash ka nisur të krijohet në disa departamente për të vlerësuar se si kurrikulat u përshtaten nevojave të tregut të punës dhe se si kjo mund të integrohet për përmirësimin e kurrikulës. Gjithsesi, ka ende punë për të bërë për përfundimin e kësaj baze të dhënash. **[BM9]**. Gjatë takimit me studentët e vitit të dytë dhe personelin administrativ, u vu në dukje se Zyra e Karrierës së Studentëve u ofron atyre udhëzime për praktikë dhe mundësi punësimi bazuar në të dhënat e mbledhura përmes rrjetit të Alumnit. **[BM5, BM8]** UGJ i trajton me kujdes sfidat e zhvillimit ekonomik rajonal falë ndërveprimit me palët e interesuara institucionale rajonale/kombëtare dhe duke marrë pjesë në konferenca që trajtojnë çështjet e zhvillimit rajonal **[AE1.35, RVV fq. 20]**. Komentet e mësuesve dhe njohuritë e palëve të interesuara e ndihmojnë UGJ-në të identifikojë prioritetet për zhvillimin e programeve të reja ose për përmirësimin e programeve të studimit bazuar në nevojat e rajonit. **[AE1.55, BM1, BM10] (Kapitulli III Standardi III.1)**
- 1.9 UGJ, në strategjinë e tij të zhvillimit, nxjerr në pah përparësitë e politikës së bashkëpunimit dhe punon për të përmirësuar bashkëpunimin me institucione të tjera akademike dhe publike në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar **[E1.33 E1.62]**. Në veprimtarinë e tij, UGJ synon të harmonizojë bashkëpunimin me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për të nxitur pjesëmarrjen në dhe organizimin e konferencave ndërkombëtare, si dhe projekteve ndërkombëtare për t'u ofruar studentëve dhe personelit akademik mundësi kërkimore dhe mobiliteti. **[AE1.34, AE1.35, AE1.36] (Kapitulli III Standardi III.2)**
- 1.10 UGJ bashkëpunon me institucione të ndryshme lokale/rajonale publike dhe private për të përmirësuar mundësitë e studentëve për kryerjen e praktikave si: me Bashkinë Gjirokastër, Këshillin e Qarkut Gjirokastër, Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë, Drejtorinë Rajonale Arsimore, bankat e nivelit të dytë, OJF, etj.). **[AE1.34,]** Përpjekjet institucionale për të pasur një bashkëpunim të mirë me institucionet publike dhe private u evidentuan në takimet me studentë, alumni dhe partnerë. **[AE1.34, AE1.62, BM5, BM10] (Kapitulli III Standardi III.3)**

⁴ <https://uogj.edu.al/>

1.11 UGJ promovon dhe zgjeron aktivitetet e lëvizshmërisë së studentëve dhe personelit në kuadër të bashkëpunimit përmes projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare **[AE1.5 Neni 92, C Dokumenti Shtesë 7]**. UGJ punon për të përmirësuar më tej procedurat e mirëseardhjes për studentët e jashtëm dhe personelin akademik, ndërkohë që merr pjesë në projekte të ndryshme të BE-së (dhe jo vetëm) për lehtësimin e shpërnguljes së studentëve dhe personelit akademik në universitete të tjera. **[AE1.36, AE1.36, AE1.37, AE1.38, AE1.39, AE1.53, AE1.64, AE1.65]**. Gjatë takimeve në terren me personelin, studentët, dhe me dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion, u ofruan shembuj të projekteve ndërkombëtare, mobilitetit dhe shkëmbimit të përvojave me universitete të ndryshme evropiane në kuadër të programeve ERASMUS. **[BM4, BM5, BM10, C Dokumenti Shtesë 7, C Dokumenti Shtesë 8] (Kapitulli III Standardi III.3)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- UGJ ka nisur të bashkëpunojë me institucionet lokale publike dhe private për mbështetjen e studentëve gjatë trajnimit praktik, i cili është kyç për punësimin e tyre në të ardhmen. Gjithashtu, ka arritur të krijojë bashkëpunime ndërkombëtare në disa fusha specifike si në degën e gjuhës dhe letërsisë greke dhe albanologjisë. **(Kapitulli III Standardi III.3)**

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi:

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Institucioni duhet të gjejë mënyra alternative për të rritur numrin e studentëve dhe për t'i pasqyruar këto në Strategjinë 2021-2025. **(Kapitulli III Standardi I.5)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimet e mëposhtme që janë në proces:

- Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikon se institucioni po punon për hartimin e një strategjie, në të cilën do të trajtohen më mirë nevojat aktuale si roli i UGJ-së si faktor kyç për zhvillimin lokal dhe veprimet që duhen ndërmarrë për përmirësimin e rekrutimit të studentëve. **(Kapitulli III Standardi I.5)**

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Universiteti i Gjirokastrës është një institucion i arsimit të lartë, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë, ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Struktura organizative është në përputhje me Ligjin 80/2015 për arsimin e lartë, por për shkak të pamundësisë së rekrutimit të personelit akademik me tituj dhe grada shkencore, institucioni nuk i plotëson kriteret në tre njësitë bazë [AE 2.24]. Organigrama [AE 2.2] është bërë publike në faqen e internetit. [www.uogj.edu.al]. Rolet e personelit akademik dhe administrativ janë paraqitur në detaje brenda strukturës së përgjithshme të miratuar. [AE 1.14, 1.14.1].

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se rekrutimi në njësi akademike mbështetet nga analiza e nevojave specifike për fakultetin, departamentin, programin e studimit dhe kurrikulën dhe nëse roli është me kohë të plotë apo të pjesshme. Vendet e lira të punës bëhen publike përmes faqes së internetit të universitetit në përputhje me rregulloren e punësimit. [AE2.1]. Proceset e rekrutimit për personelin mësimor, shkencor dhe administrativ zhvillohen sipas procesit të përcaktuar në Statut dhe Rregullore të cilat bazohen ligjin përkatës. [AE2.9]. Ngrihet një komision për shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve, vlerësimi bëhet në bazë të meritave individuale dhe kontrata e punës nënshkruhet nga rektori. [AE2.15]. Përparësi i jepet rekrutimit të personelit akademik të kualifikuar në universitete të njohura ndërkombëtare. Në përputhje me natyrën specifike të institucionit dhe pozicionin e tij gjeografik, një problem serioz i identifikuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm ishte rekrutimi i personelit akademik të kualifikuar. [BM1, BM2], (Kapitulli III, Standardi II.2). Në këtë kontekst, grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që Universiteti të marrë në konsideratë krijimin e një strategjie për rekrutimin e personelit akademik dhe zhvillimin e mekanizmave nxitës për punësimin në universitet të personelit të kualifikuar. (Kapitulli III, Standardi IV.1)

2.2 UGJ angazhohet për zbatimin e politikave integruese të personelit akademik dhe administrativ të përcaktuara në Planin Strategjik [E1.33, E1.43, E1.44, E1.45, E1.46, E1.47] [A1 SER p25]; [E1.12]; [BM 6,7&11]. Personeli mbështeti pikëpamjen në Raportin e Vetëvlerësimit se personeli akademik angazhohet në një sërë veprimtarish të tjera krahas mësimdhënies, si në seminare, ngjarje në terren dhe organizime sociale. [A1 RVV fq. 25; E2.9; [BM 6,7&11]. Universiteti mbështet integrimin e personelit akademik dhe administrativ në jetën shoqërore dhe i inkurajon ata të jenë pjesë e veprimtarive të ndryshme si aktivitetet e argëtuesë të organizuara në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë apo partnerë në qarkun e Gjirokastrës dhe më gjerë. [E.1.39], [BM 6,7&11] (Kapitulli III, Standardi IV.2). Të gjithë punonjësit e Universitetit kanë sigurim shëndetësor pasi paguajnë "Kontributin e Detyrueshëm për Sigurimin Shëndetësor". Ky kontribut paguhet në përputhje me legjislacionin e kërkuar. (Kapitulli III, Standardi II.2).

2.3 Qëllimet strategjike për zhvillimin e personelit janë përcaktuar në dokumentet dhe rregulloret strategjike të UGJ-së. UGJ zbaton politikën e trajnimit të vazhdueshëm të personelit në përputhje me këto synime. [RVV p25], [B2,3&7]. Personelit akademik i ofrohet mbështetje për t'i mundësuar ata të marrin pjesë në aktivitete trajnuese në institucione të tjera dhe jashtë vendit. [RVV p26], [AE1.39]. Universiteti ndërtoi për këtë vit akademik sistemin për mësimdhënien online. Personeli u trajnuar në mënyrë specifike për mësimdhënien online. U shpërndanë manuale dhe udhëzime, u organizuan disa

trajtime, në të cilat u trajtua fusha e teknikave të mësimdhënies online për pedagogët, me qëllim për të përmirësuar qasjen e tyre ndaj mësimdhënies. [BM7, BM8]. [RVV p26]. (Kapitulli III, Standardi IV.3).

Universiteti ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera [AE 4.24, E 1.62, E 1.63], [BM1, BM9] dhe gjithashtu mbështet mobilitetin e personelit [E 1.37, E 1.38, E 1.39], por një pjesë e vogël e personelit ka marrë pjesë deri më tani në këto programe jashtë programeve të lëvizshmërisë. Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi se mekanizmat e vlerësimit të performancës së veprimtarisë së personelit akademik nuk janë të mjaftueshme. (Kapitulli III Standardi IV.3) Megjithatë, grupi e rekomandon institucionin që të fokusohet në zhvillimin e një sistemi të brendshëm të sigurimit të cilësisë, pjesë e të cilit duhet të jetë edhe vlerësimi i performancës. Universiteti e inkurajon personelin akademik që të rrisë kualifikimet e tij, të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare [BM3, BM7] dhe të publikojë në revista [BM7], [AE 2.17]. Ata ofrojnë gjithashtu edhe mbështetje financiare për konferencat [BM2, BM8] dhe për botimet.

2.4 Para periudhës së pandemisë Covid 19, UGJ ka organizuar një sërë aktivitete për të inkurajuar dialogun social ndërmjet personelit, studentëve dhe komunitetit në përgjithësi. [RVV p26], [BM7, BM4, BM5]. Shembujt përfshijnë aktivitetet sociale, fushatën javore të ndërgjegjësimit dhe ditët e hapura për studentët e ardhshëm. Personeli akademik është përfshirë në një sërë konferencash dhe seminaresh, ndërkohë që studentët janë angazhuar me institucionet vendore në veprimtari si promovimi i librave, ndërgjegjësimi për dhunën ndaj grave, ceremonitë e mirënjohjes për figura të rëndësishme, aktivitete sportive etj. [AE 3.42]. [AE 5.22]. [AE 2.26]. Pjesë e nismës kombëtare për të mbështetur me burime njerëzore dhe ndihmë financiare janë bërë edhe studentët e UGJ-së [AE 2.54]. Këto aktivitete ishin thuajse minimale vitin e kaluar, dhe u organizuan kryesisht online. [RVV p26], [BM7, BM4, BM5]. (Kapitulli III, Standardi IV.4)

2.5 UGJ ushtron autonomi financiare në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimit të financave publike. [RVV p26], [BM1, BM2]. Bordi i Administrimit miraton buxhetin i cili hartohet nga Administratori. Personeli konfirmoi se çështjet buxhetore diskutohen në të gjitha bordet dhe komisionet përkatëse në departamente, fakultete dhe Senatit Akademik. [AE 1.15, AE 1.15.1], [AE 2.33, AE 2.34, AE 2.35, AE 2.36]. Grupi i vlerësimit të jashtëm vuri në dukje se buxheti financiar i vitit 2021 është miratuar nga Bordi i Administrimit [AE 2.17]. Meqenëse menaxhimi financiar dhe kontrolli buxhetor është i centralizuar, njësitë akademike nuk kanë autonomi të plotë financiare. Megjithatë, transparenca sigurohet përmes çështjeve financiare që diskutohen në Senatit Akademik, i cili përbëhet nga përfaqësues të personelit dhe trupës studentore. Procesi i hartimit të buxhetit dhe sistemi i menaxhimit administrativ financiar është i mirë strukturuar, efikas dhe i njohur për personelin. [RVV p26], [BM8]. Në përputhje me kërkesat statusore dhe aktet e tjera ligjore, institucioni i është nënshtruar kontrolleve periodike të jashtme ose të brendshme. [AE 2.38,], [AE 3.16], [AE 2.27], [AE 2.36]. Informacioni financiar i është vënë në dispozicion publikut përmes faqes së internetit të UGJ-së. [www.uogj.edu.al;]. Kërcënimi për shëndetin financiar të institucionit të identifikuar nga grupi i vlerësimit është pamundësia e krijimit të të ardhurave të tjera dytësore. UGJ duhet të fokusohet në gjetjen e burimeve të tjera

financiare për të kompensuar të ardhurat e ulëta nga tarifa e shkollimit për shkak të numrit të vogël të studentëve. **(Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2; Kapitulli III, Standardi VI.3)**

UGJ ka implementuar një sistem për mësimin online bazuar në paketën Microsoft Teams⁵. Faqja e internetit e institucionit është mjete kryesor i komunikimit dhe informimit. UGJ ka një strukturë përkatëse për zhvillimin dhe shpërndarjen e informacionit në nivel vertikal dhe horizontal. [www.uogj.edu.al]. Faqja institucionale e internetit ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse, informacion strategjik dhe njoftime publike në lidhje me nevojat akademike të Njësisë Kryesore dhe Bazë. Grupi i vlerësimit të jashtëm vërejtë se faqja e internetit nuk u ofron studentëve informacion në lidhje me studimet e tyre, veprimtaritë sociale ose rrjetet e alumni. Për të përmbushur në tërësi rekomandimin e bërë pas akreditimit të mëparshëm, UGJ duhet të përpiqet më shumë që t'u ofrojë studentëve informacionin e nevojshëm për programin e studimit, punësimet si dhe të informojë publikun. Informacioni i dhënë duhet të jetë i qëndrueshëm, i qartë, aktual dhe i saktë (versioni në anglisht i faqes së internetit nuk duhet të përkthehet përmes platformës "google translate"). Universiteti është gjithashtu mjaft aktiv në Facebook dhe Instagram. Studentët pohojnë se mësuesit përdorin një sërë mjetesh elektronike që t'u vënë në dispozicion studentëve burimet e nevojshme, përfshirë emaillet personale dhe paketat softuerike si Microsoft Teams. UGJ është e përkushtuar të zhvillojë infrastrukturën e saj dixhitale për të mbështetur të nxënin e studentëve dhe zhvillimin profesional të personelit akademik. Për të mundësuar koordinimin e informacionit, UGJ përdor sistemin online ESSE3, të ofruar nga RASH, si për studentët ashtu edhe për personelin akademik. **[A1 SER p27], [AE 2.20]**. Si rrjedhim, shumica e aktiviteteve institucionale janë të disponueshme në formë elektronike duke përfshirë shërbimet e protokollit dhe arkivimit, sistemet e bibliotekave. Grupi i vlerësimit identifikoi si pohim përdorimin e teknologjisë nga institucioni. Megjithatë, UGJ duhet të fokusohet në të ardhmen për t'i centralizuar të gjitha shërbimet në një sistem të centralizuar menaxhimi për të gjithë institucionin dhe veprimtaritë e tij. (Kapitulli III, Standardi VII.1) Krahasuar me numrin e studentëve, UGJ ofron një sërë laboratorësh të pajisur me pajisje bazë. **[AE 1.48]. [C12]**. Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi si pohim ngritjen e laboratorit të arkeologjisë, i cili do të mundësojë kryerjen e studimeve, punën e studentëve dhe ofrimin e shërbimeve për institucionet e tjera. **[BM7, BM8, C12] (Kapitulli III, Standardi VII.2)**

- 2.6 UGJ ka një regjistër të pasurive së tij të paluajtshme, të cilat përfshijnë tre godina shtetërore nën administrimin e MASR-së. **[A1 SER p30], [AE 2.21], [B8], [C12]**. UGJ monitoron me kujdes përdorimin e burimeve sipas kërkesave për mësimdhënie dhe kërkime shkencore. Aktualisht ka një masterplan për sigurinë, rehabilitimin e një godine të re. **[RVV p31-33]**. Infrastruktura e UGJ-së është e përshtatshme dhe e pajisur me mjediset e nevojshme për garantimin e një procesi normal të mësimdhënies. Sipërfaqja e objekteve është në raport me numrin e studentëve. **[AE 2.24]**. Falë investimit vjetor, infrastruktura e UGJ-së mbahet në standardin e kërkuar. Ekipi i vlerësimit të jashtëm komentoi se cilësia e akomodimit të të nxënit, si dhe lehtësitë dhe aksesin për individët me aftësi të kufizuara, plotësojnë në përgjithësi kërkesat ligjore. **[C12]** Në disa zona,

⁵ <https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/>

gasja për personat me aftësi të kufizuara nuk është e mundur. Ky problem, i cili u evidentua edhe në akreditimin e mëparshëm, nuk është zgjidhur ende. **[C12]**

Marrëveshje janë lidhur me organizata të tjera sportive për të ofruar lehtësitë e duhura për zhvillimin e veprimtarive sportive si p.sh. me stadiumin dhe klubet sportive vendore. **[BM4; BM5, BM8]**. Teatri përdoret për aktivitete. Spitali përdoret për t'i vendosur studentët e infermierisë në kushtet reale të punës. **[BM4; BM5]**. Auditorët dhe laboratorët plotësojnë në përgjithësi kërkesat **[C12]**. Biblioteka është e dixhitalizuar. Partnerët e universitetit janë tejet mbështetës, dhe fondet e mbledhura nga disa projekte kanë mundësuar shtimin e pajisjeve të universitetit. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1)**

2.7 UGJ ka një trashëgimi të fortë akademike dhe kulturore. Botimet e personelit akademik, punimet e diplomës së përgatitura nga studentët arkivohen që të gjitha dhe ruhen në Bibliotekë. Universiteti është i pajisur me sisteme efikase të menaxhimit të koordinuar për të siguruar kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit, përfshirë të dhënat e studentëve të mbajtura nga Sekretarët Mësimore. **[RVV p30]** Ekipi i vlerësimit të jashtëm konstatoi se objektet e ruajtjes dhe arkivimit brenda bibliotekave dhe në mënyrë elektronike përmbushnin pritshmëritë e sektorit. **[C12] (Kapitulli III, Standardi VII.4; Kapitulli III, Standardi V.2)**

2.8 UGJ kryen veprimtari mësimore, kërkimore-shkencore dhe shërbime me interes të përbashkët me palë të treta të jashtme. **[BM1; BM2, BM8]** Laboratorët brenda njërive akademike ofrojnë shërbime për institucionet e jashtme dhe drejtpërdrejt për organizatat përkatëse të tregut të punës përmes marrëveshjeve, në të cilat janë marrë parasysh rregulloret institucionale. **[AE 1.1, AE1.5]** Hulumtimi i tregut për praktikat e studentëve ka çuar në angazhimin e partnerëve të jashtëm. **[AE 4.24]**. Universiteti ofron programin e Masterit të Shkencave në Arkeologji dhe Doktoraturë në Studime Albanologjike, të cilat ndihmojnë që të dyja në mbështetjen dhe përmirësimin e ruajtjes, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. **[AE 1.14]**. Biblioteka përmban edhe tekste shkollore në gjuhën greke apo fjalorë bashkëkohorë në gjuhën greke dhe shqipe, që i shërbejnë interesave të pakicës greke, është e hapur për mbarë komunitetin. **[BM7]**. Personeli dhe studentët kanë gjithashtu mundësi të përdorin arkivat e partnerëve ose të Akademisë së Shkencave, Bibliotekës Kombëtare etj. **[BM7]. (Kapitulli III, Standardi VII.6)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy dobësi në këtë Fushë Vlerësimi.

- Angazhimi i institucionit për rekrutimin e personalit akademik tepër të kualifikuar, lë për të dëshiruar. **(Kapitulli III, Standardi II.2)**
- Mekanizmat për vlerësimin e performancës së veprimtarisë së personelit akademik, lënë gjithashtu për të dëshiruar. **(Kapitulli III Standardi IV.3)**

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti duhet të hartojë një strategji për rekrutimin e personelit akademik dhe të zhvillojë mekanizma nxitës për të punësuar në universitet personel të kualifikuar **(Kapitulli III, Standardi IV.1)**
- Institucioni duhet të fokusohet në krijimin e një sistemi të brendshëm për sigurimin e cilësisë, pjesë e së cilit duhet të jetë edhe vlerësimi i performancës së veprimtarisë së personelit akademik. **(Kapitulli III Standardi IV.3)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimet e mëposhtme që po ndërmerren:

- Rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit gjatë vitit të fundit në veprimtari të ndryshme **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**
- Laboratori i ri i arkeologjisë do të rrisë pjesëmarrjen e studentëve në studime dhe kërkime, si dhe mund ta ndihmojë universitetin që t'u ofrojë shërbime edhe institucioneve të tjera **(Kapitulli III, Standardi VII.2)**

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Synimi i programeve aktuale të studimit është të harmonizojnë kulturën dhe përvojën tradicionale të UGJ-së me nevojat e tregut të cilat janë në zhvillim të shpejtë. Kësisoj, programet e studimit të UGJ-së janë krijuar në përputhje me misionin dhe objektivin e tij. Specialistët e rinj përgatiten për të plotësuar nevojat e tregut të punës me mësues, sociologë, ekonomistë por edhe shkencëtarë të shkencave natyrore **[AE1.6, AE1.7. AE1.8, BM10]**. Vlen për t'u përmendur edhe rasti i Fakultetit Ekonomik, ku të tre programet e Financës, Administratës Publike dhe Turizmit janë të njëjtë në dy vitet e para. Në vitin e tretë, ndryshon vetëm një lëndë me përzgjedhje **[C Dokumenti Shtesë 5, BM6, BM10]**.

UGJ, me mbështetjen e Drejtorisë Rajonale të Arsimit dhe e koordinuara nga Zyra e Këshillimit për Karrierën dhe e Alumni, organizon rregullisht fushata për “ditët informuese të nxënësve të shkollave të mesme”, me qëllim për t'i informuar këta të fundit për mundësitë e studimit. **[AE2.11, BM9, C Dokumenti Shtesë 9]**. Kjo fushatë organizohet nga i gjithë personeli akademik i Gjirokastrës dhe mbulon të gjithë territorin e qytetit. Më pas, fushata mbyllet me ditën e dyerve të hapura të Universitetit. **[AE5.27, BM9]**. UGJ, duke qenë një Institucion publik i Arsimit të Lartë, publikon programet e studimit në faqen e tij të internetit <http://uogj.edu.al/arsimimi/>, ndërsa çdo fakultet dhe departament ofron në faqen e duhur të internetit informacion në lidhje me programin e studimit, d.m.th., *syllabus*, kurrikulat dhe dokumentacionin e programeve.⁶ Të gjitha programet e publikuara janë të akredituara në nivel shtetëror **[BM2, BM6]**. UGJ ofron programe studimi në të tri ciklet e studimit: Programet Bachelor (18); Master (8); Master profesional (7); Master i Shkencave (5); Programi i Doktoraturës në Albanologji; Programe profesionale 2-vjeçare (6). Në total janë 40 programe studimi **[AE1.42, SER, p35]**. UGJ ofron programe studimi me kohëzgjatje të ndryshme përfshirë ato të karakterit profesional si dhe ciklin e dytë të Masterit Profesional. **[AE1.42]**. **Ndërkohë që** programet e studimit përmirësohen çdo vit deri në 20%, programe të tjera specifike janë përmirësuar tërësisht për të pasqyruar nevojat e tregut të punës si rasti i Studimeve të Arsimit, i cili u ndryshua në masën 80%, ose krijimi i programeve specifike të studimit profesional p.sh. si Master Profesional në Infermierinë e Përgjithshme (studime dy vjeçare) **[BM6, BM8]**. Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, organet kolegjiale të UGJ-së zbatojnë rregulloren e studimeve dhe bazohen në veprimtarinë e Njësisë së Brendshme Universitare për Sigurimin e Cilësisë (NJBUSC). **[AE4.8, AE1.1, Neni 16, C Dokumenti Shtesë 3, BM11]**. UGJ-ja përcakton rregullat dhe procedurat për vlerësimin e programeve të studimit që janë po përdoren aktualisht përmes provimeve përfundimtare dhe punimit të diplomës. **[AE1.1, Neni 34]**. Fakultetet dhe departamentet e UGJ-së propozojnë kuota, që miratohen nga Senati i UGJ-së, lidhur me pranimet e reja të studentëve në bazë të programeve të studimit. **[AE3.4, AE3.6]**. **(Kapitulli I Standardi I.1)**

3.2 Krahas misionit kryesor për të mësuar ekspertët dhe studiuesit e ardhshëm të aftë për të plotësuar nevojat aktuale të tregut të punës, njësitë akademike dhe stafi i UGJ-së fokusohen në zhvillimin dhe ofrimin e programeve të studimit, objektivi i të cilave është të mësuarit i vazhdueshëm gjatë gjithë jetës. **[AE1.1, BM6]**. Për sa i përket të mësuarit

⁶ <http://uogj.edu.al/fakultetet-dhe-departamentet/>

gjatë gjithë jetës (LLL), ka module trajnimi për të përballuar nevojat e tregut në zhvillim, si p.sh. 16 module trajnimi për mësues të certifikuar nga MASR dhe Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në arsimin para universitar. **[AE1.1, BM8]**. Gjithashtu, të gjithë studentët që përfundojnë programet e studimit Bachelor kanë mundësi të vazhdojnë studimet në nivelet Master (shkencor apo profesional), apo edhe studime të avancuara dhe specializime, në rast se përfundojnë me sukses. UGJ ka një qendër funksionale për të mësuarin gjatë gjithë jetës, e cila u krijua në kuadër të projektit për përmirësimin e kapaciteteve “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të APT-së në Shqipëri”. <https://teavet.org/> **[BM6]**. Qendra e të mësuarit gjatë gjithë jetës ofron kryesisht infrastrukturën, metodologjinë dhe materialin e nevojshëm studimor për zbatimin e moduleve të trajnimit të certifikuar për mësuesit⁷. UGJ ofron një larmi programesh studimi me kohëzgjatje të ndryshme nga 1 deri në 2 vjet me karakter profesional. **[AE1.1, Neni 30]**. Ndonëse UGJ nuk ka mekanizëm për të vlerësuar përvojën e fituar dhe ndikimin e këtyre kurseve të trajnimit, numri gjithnjë e në rritje i pjesëmarrësve mund të konsiderohet si një tregues pozitiv. **[RVV, faqe 36]**. **(Kapitulli I Standardi I.2)**

3.3 Bazuar në strategjinë **[AE1.33]** dhe statutin **[AE1.1]** oferta akademike e UGJ-së përqendrohet në shtyllat kyçe si: a) cilësia e mësimdhënies dhe e studimit për të ofruar trajnimet e duhura profesionale për krijimin e kompetencave të nevojshme për tregun e punës; b) më shumë vlerë për arsimin falë bashkëpunimit dhe kërkimit ndërkombëtar; c) një përmbledhje e vazhdueshme e cilësisë si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkim, përmes mekanizmit të sigurimit të cilësisë dhe zbatimit të **[AE1.33, SER, p36]**. UGJ ka përcaktuar vizionin dhe objektivat e tij në strategjinë 2020-2025, ku përfshirja dhe përgjegjësia sociale konsiderohen si shtytësit kryesorë. **[AE1.33]**. Gjatë zbatimit të kësaj strategjie, UGJ do t'i kushtojë vëmendje të veçantë përmirësimit të programeve të studimit dhe zhvillimit të mëtejshëm shkencor të personelit akademik, me qëllim identifikimin e duhur dhe plotësimin përkatës të nevojave të tregut. **[AE3.26]**. Falë bashkëpunimit të ngushtë me institucionet publike vendase dhe shoqëritë private, UGJ ofron mundësi për një praktikë të suksesshme dhe punësim të mundshëm pas diplomimit. Kjo gjë u theksua edhe gjatë takimit me një grup mësuesish dhe përfaqësues të partnerëve të jashtëm dhe alumni. **[BM8, BM10]**. Falë kompetencës specifike dhe kontakteve me aktorët lokalë, niveli i punësimit të të diplomuarve në UGJ, veçanërisht në disa profile specifike si mësimdhënia dhe arsimi, ka qenë shumë i lartë (deri në 95%) **[BM10]**. **(Kapitulli I Standardi I.3)**

3.4 Të gjitha programet e studimit në UGJ ofrohen në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe me sistemin e Bolonjës. Për pasojë, programet e studimit janë të integruara me sistemin e lëndëve të studimeve, ndërsa lëndët vlerësohen përmes krediteve. (25h/ECTS) **[AE3.7, AE3.8, AE3.9, AE3.10]**. UGJ ofron programe studimi në përputhje me politikat e përgjithshme kombëtare, duke synuar konsolidimin e traditës shqiptare, si dhe duke respektuar në të njëjtën kohë, kualifikimet dhe kuadrin ligjor evropian **[RVV, faqe 37]**. Larmia e disiplinave mbetet objektivi parësor gjatë hartimit të programeve të studimit, ndërkohë që përfshirja e gjuhëve të huaja në të gjitha programet dhe në të gjitha nivelet konsiderohet si një faktor shtesë për rritjen e mobilitetit të studentëve dhe personelit akademik **[AE3.27]**. Edhe pse aktualisht nuk ka

⁷ <https://trajnime.arsimi.rash.al/Trajnimes/TrajnimeTeavet>

një program të përbashkët me një IAL tjetër ndërkombëtar, angazhimi dhe përpjekjet për ta arritur këtë objektiv përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ndërkombëtare, nuk mungojnë. **[AE3.28]**. Gjatë një takimi me personelin akademik, **[BM8]**, GVJ konfirmoi gjithashtu se mobiliteti ndodh sa herë që ofrohet mundësia. Statuti i UGJ-së i njuh kreditet që studentët mund të kenë marrë gjatë ndjekjes së studimeve në një Institucion tjetër të Arsimit të Lartë **[AE1.1, Neni 34]**. **(Kapitulli I Standardi I.4)**

3.5 Sipas Rregullores së Universitetit, ngarkesa mësimore e pedagogut me kohë të plotë në UGJ është mesatarisht 1536 orë. **[AE1.5, Neni 26]**. Ngarkesa e punës së pedagogut përfshin mësimdhënien, kërkimin shkencor, punën institucionale dhe një model kontrate **[E3.32.1]**. Ilustrimi i dokumenteve dhe fakteve raportuese të siguruara nga UGJ **[AE3.29, AE3.30, BM8]** ofron informacion për ngarkesën mësimore të pedagogëve gjatë vitit duke e klasifikuar atë në mësimdhënie, laborator, asistencë në procesin mësimor (kërkime, botime), veprimtari mbështetëse për institucionin **[AE3.32, BM6]**. Ngarkesa mësimore e pedagogëve përcaktohet në përputhje me aktet nënligjore **[AE3.31]**. Ngarkesa shtesë e pedagogëve financohet nga buxheti i Universitetit **[AE3.31]**. Drejtuesit e drejtorive dhe qendrave shkencore angazhohen në mësimdhënie në përputhje me kuadrin ligjor **[BM8]**. **(Kapitulli I Standardi I.5)**

3.6 Kurrikula e programeve të studimit për të gjitha njësitë akademike gjendet në faqen e internetit të Universitetit <http://uogj.edu.al/arsimimi/>, ndërsa programet specifike të studimit dhe kurrikulat e tyre janë të disponueshme në faqen e internetit të departamentit përkatës që është përgjegjës për realizimin atij program studimi <http://uogj.edu.al/departamenti-i-historise/> **[BM4, BM5]**. Objektivat e programeve të studimit përputhen me objektivat e përgjithshme të UGJ-së. Kriteret për pranimin e studentëve janë në përputhje me ligjet dhe kuotat e dhëna në nivel kombëtar, të miratuara nga senati **[AE3.31, C Dokumenti Shtesë 4]** dhe publikohen në faqen e internetit të UGJ-së. Pasi futeni në faqen e kursit, aty do të gjeni planet e lëndëve për çdo program studimi. Kjo i jep mundësinë personelit, studentëve dhe studentëve të ardhshëm të kenë akses të shpejtë në këtë informacion. Kjo është një nga pikat e forta të UGJ-së (shikoni <http://uogj.edu.al/arsimimi/>) **[BM4, BM5]**. **(Kapitulli I Standardi I.6)**

3.7 Në statut përcaktohet se studimet në UGJ janë të organizuara në tre cikle radhazi duke iu referuar niveleve 6, 7 dhe 8 të kuadrin shqiptar të kualifikimeve. Në statut është shpjeguar edhe kalimi ndërmjet këtyre tri niveleve **[AE1.1, Neni 30]**. Të gjitha programet e ciklit të parë, d.m.th., programet 3-vjeçare të nivelit Bachelor organizohen me 180 ECTS dhe u ofrojnë studentëve mundësinë për të vazhduar studimet Master të nivelit të dytë (shkencor apo profesional), si në çdo IAL. **[AE3.26]**. Fakultetet e UGJ-së organizojnë 6 programe studimi të nivelit bazë dyvjeçar, falë të cilave studentët fitojnë kompetenca në fusha profesionale (joshkencore). **[AE1.42]**. Programe studimi janë krijuar nga njësitë akademike të UGJ-së në përputhje me ndarjen në disiplina si lëndë bazë, lëndë karakteristike, lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë plotësuese duke i pajisur studentët me njohuritë bazë të profesioneve dhe parimeve shkencore përkatëse **[RVV, faqe 39]**. Në përgjithësi, studentët mendojnë se programet aktuale të studimit dhe organizimi i njësive akademike, i pajisin ato me aftësi të përgjithshme dhe specifike, si dhe formimin e duhur, duke u ofruar njëkohësisht edhe mundësinë për ta zgjeruar fushën e studimeve përkatëse në një shkallë dhe thellësi më të madhe **[BM4, BM5]**. Në

takimin me studentët dhe personelin e administratës, GVJ-ja vuri re se Shoqata Alumni e UGJ-së është e pranishme dhe kërkon të ndihmojë studentët e sapo diplomuar të kenë kontakte më të mira për mundësi punësimi falë edhe partnerëve të jashtëm të UGJ-së [BM5, BM10]. Në Rregulloren e UGJ-së [AE1.5 Neni 65] parashikohet që studentët mund të transferohen, por me kusht që transferimi të kryhet brenda të njëjtit cikël studimi dhe me vendim të një komisioni me tre anëtarë, të përbërë nga pedagogë të degës përkatëse dhe të krijuar nga departamenti (njësia bazë akademike) për të vlerësuar ekuivalencën e notave dhe krediteve [AE3.41]. Çështjet e transferimit rregullohen në Statutin e UGJ-së [AE1.1, Neni 33]. *(Kapitulli I Standardi I.7)*

3.8 Informacioni i marrë falë fushatave të rregullta të zhvilluara me nxënës të shkollave të mesme, të cilëve u prezantohet oferta dhe organizimi i studimit gjatë “ditëve të informimit të studentëve”, harmonizohet me veprimtaritë e koordinuara nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, me qëllim që kalimi i studentëve në vitin e tyre të parë të studimeve të jetë sa më i lehtë [AE2.11]. Sipas traditës së UGJ-së, i gjithë personeli akademik që jep mësim në vitin e parë, u ofron mbështetje të vazhdueshme studentëve derisa këta të fundit të njihen me procedurat dhe akademikët [BM10]. Gjatë takimeve me GVJ, studentët konfirmuan [BM4, BM5] se orientimi i tyre mbështetet më tej nga faqja e internetit e universitetit, ku ata gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm për organogramën e UGJ-së dhe kontaktet e zyrave kryesore, ku mund të paraqesin çështjet e tyre, si zyra e këshillimit të karrierës. Në Rregulloren e UGJ-së dhe Rregulloren e Programit të Studimit jepet një pasqyrë të qartë e veprimtarive, që janë në interes të studentëve, jo vetëm në fillimet e kursit, por edhe gjatë studimeve të tyre akademike [AE1.5, AE4.8]. ESSE3, në të cilën gjenden planet e lëndëve për çdo program studimi, u ofron studentëve mundësinë të kenë informacion të qartë, duke reduktuar hapat proceduralë. [BM8, BM9]. UGJ promovon zhvillimin e karrierës së studentëve përmes shpërndarjes së bursave për studentët me rezultate më të larta [BM4, BM5, BM9]. Faktet nga programet e studimit [AE3.39] tregojnë se raporti i personelit akademik me kontratë dhe i personelit me kontratë të përkohshme është 66.7/33.9% (më i detajuar për secilin fakultet: FESH 79/42; FSHN 60/29; FE 33/17). Këto shifra por edhe mbikëqyrja e detajuar e fakteve të ofruara tregojnë se ekuilibri është ruajtur mirë jo vetëm në nivel universitar, por edhe në fakultet dhe programe studimi. Strategjia e Zhvillimit 2020-2025 [AE1.33] synon të rrisë nivelin e kualifikimeve për personelin akademik, ndërkohë që sistemi i pikëzimit favorizon personat me nivelin më të lartë të kualifikimit. *(Kapitulli I Standardi I.8)*

3.9 Personeli akademik i departamenteve i harton programet e studimit të ciklit të dytë bazuar në kërkimin e tyre, ekspertizën e mbledhur dhe përmes një procesi komentesh të marra nga vlerësimi i studentëve [AE1.42, C Dokumenti Shtesë 2]. Sipas Rregullores së UGJ-së [AE1.5 Neni 30], ngarkesa mësimore ndahet mes këtyre veprimtarive: a) mësimdhënies; b) kërkimit shkencor; c) kontributit institucional; kontributit profesional. Faktet [AE3.32.1] tregojnë se 25-30% e kohës së një pedagogu e zë kërkimi shkencor, pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare dhe bashkëpunimi në projekte kërkimore, përfshirë punën që bëjnë për përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit dhe pjesëmarrjen në detyrat akademike të departamentit [BM8]. Në rast se personeli akademik me kohë të plotë kategorizohet me orientim kërkimor, ngarkesa e tij mësimore mund të ulet deri në 35% [AE1.5 Neni 31, BM8]. Rreth 70-80% e kohës së punës i kushtohet veprimtarive të mësimdhënies, të cilat ndahen në

përgatitjen personale për dhënien e leksioneve, mësimdhënie ballë për ballë me studentët, konsultime dhe mbikëqyrje teze [AE1.5 Neni 26, AE3.32.1, BM8]. Përgatitja e tezës, d.m.th., modeli, prishmëritë, kërkesat dhe hapat e nevojshëm si mbështetja akademike, procedurat, mbrojtja e tezës etj., janë të përcaktuara në manualin përkatës [AE4.8]. Praktikrat profesionale zhvillohen si pjesë e kurrikulave në bashkëpunim me shoqëri private dhe shtetërore dhe mbyllen me vlerësimin specifik të këtij aktiviteti [AE3.45]. Zyra e Këshillimit të Karrierës i ka të plotësuarat të dhënat për punësimin e të diplomuarve [C Dokumenti Shtesë 6]. Integrimi më i mirë i këtyre të dhënave dhe komenteve të punëdhënësve ndihmon në krijimin e një pamjeje të plotë të nevojave të tregut të punës dhe marrjen e komenteve lidhur me vlerësimin e programeve të studimit. Sa herë që ka qenë e nevojshme dhe e mundur, UGJ ka ftuar personel akademik vendas dhe të huaj ose njerëz me njohuri të veçanta në një fushë të caktuar [AE3.39, BM10]. *(Kapitulli I Standardi I.9)*

3.10 Në statut përcaktohet se studimet në UGJ organizohen në tre cikle radhazi duke iu referuar niveleve 6, 7 dhe 8 të kuadrit shqiptar të kualifikimeve, ndërsa kalimi ndërmjet këtyre tre niveleve shpjegohet qartë në statut [AE1.1, Neni 30]. Të gjitha programet e ciklit të parë, d.m.th., programet 3-vjeçare Bachelor organizohen në kurse me 180 ECTS. Për rrjedhojë, studentët kanë të drejtë që të vazhdojnë studimet Master të nivelit të dytë (shkencor apo profesional) [AE3.26]. Bazuar në strategjinë e UGJ-së, bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe mobiliteti i mësuesve dhe studentëve në programe të ndryshme, është një nga përparësitë e këtij universiteti [AE1.33]. GVJ vëren se programet e studimit të UGJ-së synojnë të lehtësojnë dhe bëjnë të mundur mobilitetin [BM4, BM5, BM9]. Kjo do të thotë se UGJ mbështet bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar [AE1.33, AE1. 64]. Në përfundim të programeve të studimit, të ciklit të parë dhe të dytë, studentët pajisen me diploma dhe suplementet e tyre në gjuhën shqipe dhe angleze. [AE3.41]. Gjatë takimeve me studentët e ciklit të dytë të studimeve, GVJ ka konstatuar gjithashtu se niveli i njohjes së gjuhëve të huaja është i kënaqshëm, ndërsa kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve përfshirë njohuritë e gjuhëve të huaja përkatëse për programin e studimit, përcaktohen në Statutin E UGJ-së. [AE1.5 neni 63]. Për çdo program studimi, UGJ praktikon njohjen e ekuivalencës deri në 75% të rasteve të mobilitetit [AE3.41, BM9]. *Kapitulli I Standardi I.10*

3.11 Në programet e studimit kombinohet komponenti teorik dhe zbatimi praktik i njohurive: në varësi të programit të studimit, mjetet e zbatimit praktik ndryshojnë nga veprimtaritë praktike te laboratorët [RVV, faqe 41]. Praktika është e përfshirë në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë [AE1.5 Neni 69, BM5], ndërsa UGJ kërkon të ofrojë përputhjen e duhur mes programit të studimit dhe institucionit të praktikës [AE1.5 Neni 101, BM10]. UGJ mban të dhëna për punën e studentëve gjatë praktikës, ecuria e të cilëve vlerësohet nga mësuesit [AE3.45, BM10]. Gjatë takimit me studentët, GVJ vuri re se përfshirja e tyre në projektet kërkimore fokusohet kryesisht te pyetësorët dhe puna në terren, por jo në përgatitjen e eseve apo projekteve. [BM5]. Gjatë programit të kursit të studimit, UGJ organizon dhe mbështet financiarisht praktikrat mësimore, të njohura si praktika në terren. Këto praktika kryhen jashtë universitetit dhe zgjasin disa ditë [AE3.45]. *Kapitulli I Standardi I.11*

3.12 Personeli i departamentit dhe i fakultetit të UGJ-së kërkon të përfshijë disiplina karakteristike (me fokus profesional) deri në 90-99 ECTS ekuivalente me 50-55% të ngarkesës së të gjithë programit të studimit, ndërkohë që projektet karakterizuese dhe integruese përbëjnë 17% të ngarkesës **[RVV, faqe 41]**. Fokusi në disiplinën profesionale të programit të studimit është në përputhje me misionin e UGJ-së dhe strategjinë e zhvillimit për të plotësuar nevojat e tregut të punës. Falë programeve të studimit në të gjitha nivelet, studentët përfitojnë kompetenca të përgjithshme dhe të veçanta profesionale për të krijuar një profil të përshtatshëm profesional në tregun e punës **[AE3.45, BM9]**. Gjithashtu, një kriter kyç për krijimin e programeve të reja të studimit varet nga mënyra e justifikimit të një programi studimi kundrejt nevojave të tregut të punës, të cilat do të plotësohen nga studentët e diplomuar. **[AE1.5 Neni 43]**. Praktika profesionale kryhet në të dy nivelet e studimit dhe në të gjitha programet **[BM5]**. Gjatë vizitës në terren të GVJ në UGJ, prania e infrastrukturës mësimore (si salla e praktikës pedagogjike të infermierisë etj.) hapësira laboratorike dhe pajisjet e tyre evidentuan punën e studentëve në aspektin e formimit praktik **[BM12]**. **(Kapitulli I Standardi I.12)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Edukimi për të mësuarin gjatë gjithë jetës e pati zanafillën nga një projekt i suksesshëm për trajnimin e mësuesve, një pikënisje e mirë për të ngritur një qendër të plotë funksionale për të mësuarin gjatë gjithë jetës **(Kapitulli I Standardi I.2)**
- Në faqen e internetit mund të gjendet plani i kursit për çdo program studimi, gjë që u jep mundësinë studentëve ekzistues dhe atyre të ardhshëm që të kenë akses të shpejtë në këto informacione. **(Kapitulli I Standardi I.6)**.
- UGJ, në bashkëpunim me zyrën e punës, organizon për studentët trajnime të mbështetura financiarisht **(Kapitulli I Standardi I.11)**
- Kurrikula në disa departamente si në studimet e mësuesisë, është përmirësuar në shkallën 80 për qind, falë komenteve të dhëna nga studentët dhe palët e interesuara. Programet e reja, si programi i ciklit të dytë të infermierisë, krijohen sipas nevojave të tregut. Kjo përvojë duhet të shtrihet edhe në departamente të tjera (jeni të lutur të shikoni rekomandimin e mëposhtëm). **(Kapitulli I Standardi I.1)**

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Tre programet e studimit Bachelor në Fakultetin Ekonomik kanë kurrikula të njëjta në dy vitet e para dhe specializimi është i përqendruar vetëm në vitin e tretë. Pavarësisht koncepteve ndara, kjo shkallë ngjashmërie bën që ndikimi i specializimit të programeve përkatës të studimit, të jetë shumë i vogël. **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Qasja aktuale për rekrutimin e studentëve lë për të dëshiruar për sa i përket balancimit të rezultatit të ndryshimeve demografike që kanë ndodhur në zonë. Numri

i vogël i studentëve kufizon të ardhurat financiare të gjeneruara nga tarifat e shkollimit. Gjithashtu, kjo kufizon edhe aftësinë e UGJ-së për kërkim dhe ndërkombëtarizim. **(Kapitulli I Standardi I.1)**

- Përfshirja e studentëve në projektet kërkimore përqendrohet zakonisht te pyetësorët dhe puna në terren, por jo në plotësimin apo realizimin e ndonjë eseje apo projekti **(Kapitulli I Standardi I.11)**
- Informacionet e kufizuara për profilet e studentëve të punësuar, kufizojnë cilësinë e sugjerimeve lidhur me përmirësimin e programeve të studimit sipas nevojave të tregut **(Kapitulli I Standardi I.10)**

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi rekomandimet e mëposhtme:

- Programet e studimit duhet të kenë kurrikula të dallueshme në dy vitet e para të programit Bachelor në Fakultetin Ekonomik, duke marrë gjithashtu parasysh edhe përvojën e universiteteve të tjera. Kjo mund të konsiderohet si një qasje për harmonizimin e të gjitha sugjerimeve të dhëna për përmirësimin e kurrikulave në tre shtylla kryesore: 1) komentet e studentëve në fund të çdo kursi; 2) sugjerimet e palëve të interesuara lidhur me aftësitë e nevojshme që u mungojnë studentëve; 3) rezultatet e kërkimeve të kryera nga mësuesit në një fushë të veçantë të kursit **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Një strategji afatshkurtër/afatmesme për rritjen e numrit të studentëve. Strategjia ekzistuese nuk përmban asnjë veprim të veçantë që mund të ndërmerret për zgjidhjen e këtij problemi. **(Kapitulli I Standardi I.1)**
- Rritja e angazhimit të studentëve, veçanërisht të atyre të ciklit të dytë dhe të tretë të studimit, në veprimtari kërkimore duke përdorur projektet ndërkombëtare ose punën në terren. **(Kapitulli I Standardi I.11)**
- Në vijim të rekomandimeve të dhëna gjatë akreditimit të mëparshëm institucional, të dhënat e studentëve të punësuar duhet të monitorohen dhe të ndahen për të identifikuar profilet e kërkuara nga tregu për përmirësimin e programeve të studimit sipas rastit. **(Kapitulli I Standardi I.10)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm i cili është duke u ndërmarrë:

- Strategjia e Universitetit do të përmirësohet për të pasqyruar më mirë nevojat e UGJ-së, veçanërisht numrin e vogël të studentëve. **(Kapitulli I, Standardi I.10)**

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Organizimi dhe dokumentimi i kurrikulës së programeve të studimit që ofrohen në UGJ me shkrim janë përcaktuar qartë në statutin dhe rregullore **[A.E1.1; A.E 1.5]**, si edhe në rregulloren për njësitë bazë **[A.E1.6; A.E1.7; A.E1.8]**, e cila siguron zbatimin në kushtet e duhura të programeve të studimit në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë. Gjithashtu, informacione jepen për institucionin, për çdo program studimi, strukturat përgjegjëse akademike dhe të tjera bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm të trajnimit të programit të studimit, stafin akademik për zbatimin e programit, kurrikulën, infrastrukturën e disponueshme të programit, kriteret e pranimit, kurrikulën, *syllabus* e lëndëve, rregulloren e programit të studimit dhe suplementet e tjera të diplomës **[A.E3.7; A.E3.8; A.E3.9; A.E3.10]**. Orari i përgjithshëm bëhet publik në fillim të çdo semestri ku përcaktohen qartë format e mësimi, dita, ora dhe auditori ku do të zhvillohet mësimi, si dhe pedagogu përkatës. **[A.E4.1]**. Orari mësimor publikohet në faqen e internetit të UGJ-së **[A.E4.2]**, dhe gjithashtu afishohet në mjediset e UGJ-së. Sistemi elektronik ESSE3 është krijuar nga UGJ për regjistrimin e studentëve, ku çdo student dhe personel akademik i UGJ-së ka llogarinë e tij personale dhe manualin e plotë se si mund të aksesojnë për të përdorur sistemin **[A.E2.20; BM4; BM5]**. Stafi akademik në UGJ caktohet për çdo fushë të specialitetit **[A.E3.71]**. UGJ ka 25 laboratorë **[A.E1.48]**, të cilët garantojnë kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e trajnimit praktik dhe profesional të studentëve. Megjithatë, studentët janë të interesuar të rrisin numrin e orëve praktike dhe të përmirësojnë laboratorët ekzistues. Situata e pandemisë ka bërë që disa praktika laboratorike të zhvillohen online **[BM4]**. Që studentët të jenë të përgatitur më mirë nga ana praktike, praktika duhet të zhvillohet më shumë në programet Bachelor dhe jo vetëm në studimet Master të Shkencës **[B.M5]**. Gjithashtu, mungojnë pajisjet për kërkimin shkencor **[C.11]**, që mund të publikohen në revista. Gjithashtu, UGJ ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme për kryerjen e praktikave mësimore sipas fushës specifike **[A.E4.24; B.M10]** dhe të mbikëqyrura nga pedagogu përkatës **[A.E3.45]**. Për sa i përket programit të doktoraturës, UGJ ka rregulloren e saj, në të cilën përcaktohen qartë rregullat dhe kriteret e diplomimit **[A.E1.19]**. Studentëve u jepet literatura bazë dhe mbështetëse për programin e studimit për secilën lëndë të parashikuar në *syllabus* e lëndës **[A.E3.20]**, por edhe përmes bibliotekës së UGJ-së **[A.E4.5]**. UGJ është në procesin e dixhitalizimit të bibliotekës. Biblioteka ofron abonime në revista të rëndësishme dhe gjithashtu lejon aksesin në bibliotekën online **[BM3]**. Literatura bazë e çdo departamenti aprovohet në fillim të çdo viti akademik **[A.E4.4]**. UGJ ka përcaktuar standardet dhe kriteret për literaturën që përdoret për studentët, e cila duhet të rishikohet dhe miratohet në departament. **[A.E4.5]**. Fakultetet përgatisin kërkesën për literaturë të re, e cila mund të blihet nga fondet e UGJ-së, por edhe nga donacione të ndryshme **[A.E4.6; A.E4.7]**. Gjithashtu, studentët e UGJ kanë akses në platformën dixhitale U.LIBRARY <https://ulibrary.rash.al> ku mund të gjejnë edhe literaturë mbështetëse për kurrikulën dhe jo vetëm. Biblioteka ofron literaturë në gjuhë të huaja, ndërsa vitin e kaluar, për shkak të situatës pandemike, literatura u ofrua më shumë online **[BM5]**. Megjithatë, UGJ duhet të mendojë seriozisht në të ardhmen për të përmirësuar sistemin ESSE3, në mënyrë që stafi akademik të vendosë në ESSE3 materialet e ndryshme, të cilat do të jenë në dispozicion të studentëve. Kësisoj, ky program do të jetë

më i dobishëm, megjithëse aktualisht këto materiale krijohen përmes ekipeve. **[BM7]**. Sidoqoftë, ESSE3 është një platformë zyrtare. *(Kapitulli I Standardi II.1)*.

4.2 UGJ ka përgatitur rregulloren për rregullat dhe kërkesat për diplomim **[A.E1.5]** si dhe rregulloret për njësitë bazë **[A.E1.6; A.E1.7; A.E1.8]**. Rregullat dhe kërkesat për provimin e diplomimit miratohen nga strukturat përgjegjëse të universitetit dhe u bëhen të njohura të gjithëve përmes rregullores. UGJ bën të njohura (shpall në vende të dukshme) kriteret dhe procedurat e diplomimit, sipas rregulloreve përkatëse. Kriteret dhe procedurat e diplomimit, sipas rregulloreve përkatëse, afishohen në stendën e çdo fakulteti dhe publikohen në faqen zyrtare të UGJ-së **[RVV, p 44]**. Studentët informohen publikisht në fakultetet përkatëse, si dhe në faqen e internetit të institucionit për datat e provimeve dhe të diplomimit **[RVV, P 44; BM4; BM5]**. Është shumë e rëndësishme që studentët të kenë mundësinë të takohen, sipas nevojës, me udhëheqësit e tyre për të diskutuar rreth provimit të diplomës **[BM4]**. Në korrigjimin e provimeve respektohet anonimiteti i studentëve dhe të gjitha provimet me shkrim bëhen duke e fshehur emrin e studentit, procedurë që është përcaktuar në rregulloren e studimit **[RVV, fq. 44]**. Gjithashtu, ankimi i rezultateve të provimit shqyrtohet nga një komision i ngritur në përputhje me rregulloren e studimit, rregulloret e fakulteteve dhe programin përkatës të studimit, duke respektuar gjithmonë afatet e ankimit **[A.E4.8]**. Nga takimi i studentëve, u vu re qartë se jo të gjithë studentët janë të vetëdijshëm për ekzistencën e Këshillit të Etikës, megjithëse ka raste që disa studentë mësohen duke kopjuar **[BM5]**. Kodi i Etikës i përgatit në fund të vitit 2020, por është inkurajues fakti që do të zbatohet si për stafin akademik ashtu dhe studentët që nuk respektojnë Kodin e Etikës. Studentët kanë akses në rezultatet e provimeve personale, duke respektuar parimin e konfidencialitetit **[RVV, fq. 44]**. Ata mund t'i verifikojnë rezultatet e provimeve, të cilat komunikohen verbalisht edhe nga komisioni brenda afatit të përcaktuar në rregullore **[A.E2.46]**. *(Kapitulli I Standardi II.2)*

4.3 Personeli akademik i UGJ-së vlerësohet nga strukturat e institucionit që ndjekin zbatimin cilësor të programeve të studimit, si dhe nga strukturat drejtuese si Dekanati, departamenti përmes analizave vlerësuese që kryhen gjatë vitit akademik dhe nga zv. rektori i caktuar për të vlerësuar performancën e pedagogut **[RVV, fq. 45]**. Për vlerësimin e procesit mësimor, UGJ përdor si pyetësorët institucionalë, ashtu dhe pyetësorët për procesin mësimor, të organizuar nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC) **[A.E1.1; A.E.1.3]**. Studentëve u jepet mundësia të vlerësojnë institucionin dhe cilësinë e mësimdhënies **[A.E4.9]**. Megjithatë, pyetësi përmban shumë pyetje dhe nuk është specifik për performancën e mësimdhënies. Studentët i plotësojnë pyetësorët, por nuk marrin komente ose sugjerime, dhe rezultatet nuk janë transparente **[BM5]**. UGJ i vlerëson arritjet e stafit të tij në mësimdhënien vjetore dhe përmes analizës kërkimore në nivel departamenti **[A.E2.40]**. Personeli akademik plotëson fletën e vet të vlerësimit për veprimtarinë e tij shkencore, e cila dorëzohet dhe pasurohet në fund të çdo viti akademik **[RVV, fq. 45]**, por i mungon fleta e vlerësimit. Në çdo vit akademik, të gjitha programet e studimit rishikohen për t'u përditësuar dhe përmirësuar në mënyrë që kurrikula të jetë sa më funksionale dhe të përshtatet më mirë me kërkesat e tregut të punës **[RVV, fq. 45]**. Edhe pse përfshirja e sektorit publik dhe privat nuk është e mjaftueshme, kjo bëhet kryesisht në baza individuale **[BM10]**. Diskutimet nisin në nivel departamenti. Më pas, propozimet për ndryshime i drejtohen Dekanatit ku zhvillohet diskutimi përkatës për propozimet e bëra, të cilat i përcillen Senatit Akademik për diskutim dhe vendimmarrje të mëtejshme **[RVV, fq. 45]**. Megjithatë nuk është e qartë se si merret mendimi i studentëve lidhur me këtë çështje. *(Kapitulli I Standardi II.3)*.

4.4 Departamenti në UGJ është një strukturë bazë, që nxit përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, ndërkohë që politika e universitetit nxit mobilitetin e personelit akademik që të shkëmbejë përvojat që do të çojnë në përmirësimin e mësimdhënies në universitet **[RVV, fq. 45]**. Gjithashtu, UGJ inkurajon dhe mbështet stafin akademik në fushën e kërkimit shkencor, si dhe ofron lehtësira duke ulur ngarkesën mësimore, duke dhënë një vit pushimi në shtatë vjet, etj., me qëllim që stafi të fokusohet në kërkimin shkencor. **[RVV, fq. 45; BM8]**. Është shqetësues fakti se një pjesë e mirë e stafit akademik ka dalë në pension **[BM3; BM9]** dhe shumë të tjerë janë shpërngulur jashtë shtetit ose kanë shkuar në universitetet e tjera të Shqipërisë. **[BM7]**. Thuhet se stafi akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, duke marrë pjesë në trajnime brenda dhe jashtë vendit, duke u angazhuar në projekte, partner i të cilave është edhe UGJ **[RVV, fq. 46]**, Megjithatë, nuk është dokumentuar asgjë dhe UGH nuk ka organizuar trajnime për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Këto trajnime bazohen kryesisht në projekte të ndryshme, p.sh me Universitetin e Ghent-it, Belgjikë **[BM6]** dhe kryesisht për personelin e vjetër **[BM3]**. Megjithatë, është e rëndësishme që stafi akademik ka kryer trajnime për mësimdhënien dhe për zhvillimin e provimeve online, në mënyrë që mësimi të zhvillohet me sukses. Platforma për mësimdhënien online është e ngritur dhe është në përdorim **[A.E3.46; BM8]**. Gjithashtu, UGJ ka përgatitur një pyetësor për mësimin online. Nga rezultatet e përfuara kanë dalë disa mangësi të cilat do të publikohen së shpejti dhe me siguri, do të përmirësojnë zhvillimin e mësimin online **[BM8]**. UGJ zbaton projekte për ngritjen e kapaciteteve, fokusi i të cilave është ngritja e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve dhe kualifikimeve, përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës, përmes krijimit të laboratorëve të dedikuar për këtë qëllim dhe shkëmbimit të vizitave studimore mes partnerëve. Informacionet për projektet ku UGJ është partner, janë të publikuara në faqen e internetit, së bashku me lidhjet përkatëse për secilin projekt⁸. Senati i UGJ-së ka vendosur modalitetet dhe standardet për rekrutimin e stafit akademik, ndërsa departamentet i përcaktojnë kriteret sipas specifikave që kanë në lidhje me këto rekrutime **[A.E 2.1; BM9]**. UGJ ka një mungesë të theksuar të terreneve sportive në mjediset e saj, por falë marrëveshjeve me institucionet publike dhe private, ajo ka arritur t'i sigurojë hapësirat e nevojshme **[A.E4.24]**. *(Kapitulli I Standardi II. 4)*.

4.5 3 njësitë në UGJ grupohen sipas disiplinave përkatëse mësimore, në të cilat funksionojnë grupet përkatëse mësimore-kërkimore dhe studime të ndryshme kërkimore kryhen në fusha të veçanta **[RVV, fq. 46]**. UGJ planifikon çdo vit një buxhet të caktuar për kërkimin shkencor dhe ka marrë financime nga shteti. Gjithsesi, kjo varet nga numri i studentëve. Buxheti që marrin nga shteti ka pësuar një rënie në vitet e fundit **[BM1]**. Megjithatë, përparësia e UGJ-së është që të kthehet në një Qendër Kërkimore **[BM2]**. Sidoqoftë, kjo përparësi është e vështirë të përmbushet për momentin, pasi stafi akademik pjesën më të madhe të kohës së punës e kalon duke dhënë mësim, me një raport prej 75% në mësimdhënie dhe 25% në kërkime. UGJ nuk ka bërë klasifikime për mësues dhe studiues **[BM8]**. Bazuar në strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit, grupet kërkimore janë të fokusuara kryesisht në kërkime dhe botime **[A.E1.33]**. Gjithsesi, aktualisht UGJ nuk ofron mbështetje financiare shtesë për ata persona që botojnë vepra brenda dhe jashtë vendit **[BM3]**. Për më tepër, nga takimet me stafin akademik u mësua se vetëm një grup kërkimor nga Departamenti i Ekonomisë është shpallur fitues i një

⁸ <http://uogi.edu.al/projekte-nderkombetare/>.

projekti kërkimor **[BM8]**, por në të kaluarën disa grupe kërkimore kanë fituar tre projekte. Megjithatë nuk është e qartë për cilat projekte kërkimore bëhet fjalë **[BM8]**. Njësia bazë është përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës kërkimore-shkencore të grupeve kërkimore dhe çdo departament ka përgjegjësinë të hartojë një raport vjetor që vlerëson ecurinë e punës kërkimore-shkencore të grupeve kërkimore. Përgjegjësi i Njesisë Bazë promovon të gjitha arritjet lidhur me botimet didaktike-shkencore dhe projektet e ndryshme promovohen në faqen e UGJ-së. Është shumë më e rëndësishme që njësitë kryesore të UGJ-së të mbështeten financiarisht në mënyrë transparente dhe që plani i buxhetit institucional të përfshijë financimet për kërkime që mund të kryhen nga çdo departament. **[A.E 1.1]**, Në nenin 36, 37 dhe 38 ndarja e këtij buxheti për departamentet nuk është përcaktuar qartë, ndërkohë që **[A.E1.5]** në nenin 102, pika 4 përcaktohet se veprimtaria kërkimore-shkencore e aplikuar është pjesë përbërëse e buxhetit të UGJ-së për çdo vit akademik. Megjithatë, është inkurajues fakti që për këtë vit UGJ ka në dispozicion rreth 3.5 milionë lekë për projekte kërkimore **[BM2; BM6]**. Njësitë bazë dorëzojnë propozimet, të cilat vlerësohen më pas nga një grup i vlerësimit të jashtëm **[BM6; BM8]**. Gjithashtu, rregullorja e organizimit të veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe administrative të Universitetit të Gjirokastrës është ndryshuar me vendim të Senatit Akademik datë 08.09.2020. **(Kapitulli II Standardi I. 1).**

4.6 UGJ mirëpret dhe inkurajon propozimet kërkimore dhe vendos për ecurinë e tyre gjatë gjithë vitit akademik, bazuar në burimet e miratuara financiare **[A.E2.15; A.E2.16]**. Në fakt, në këto dokumente tregohet struktura e UGJ-së, numri i personelit dhe ndryshimi i kategorive të pagave. UGJ po bashkëpunon me institucione të tjera kërkimore publike dhe private veçanërisht në fushën e mësimdhënies **[A.E1.62]**, por jo shumë për projektet tipike kërkimore, kryesisht përmes lidhjeve individuale të stafit në rajon dhe më gjerë me projekte të përbashkëta **[BM3]**. UGJ ka bashkëpunim me institucione të ndryshme publike apo private brenda dhe jashtë vendit **[C.12; C.13]**. Gjithsesi, ky bashkëpunim nuk është shumë i kënaqshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të kërkimeve. **(Kapitulli II Standardi I.2).**

4.7 UGJ organizon dhe merr pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga institucione të tjera. Ky informacion pasqyrohet në faqen e internetit⁹ të UGJ-së dhe në rrjetin zyrtar social¹⁰. UGJ ka organizuar nga viti 2016-2021 12 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me tema të ndryshme **[A.E4.18]**. Personeli akademik i UGJ-së ka marrë pjesë edhe në konferenca shkencore ndërkombëtare, ka botuar artikuj shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare apo ka pasur angazhime të tjera të këtij lloji **[A.E4.22]**. Në këtë dokument përfshihet miratimi i përbërjes së bordit të buletinit shkencor, dhe kërkimit universitar të UGJ-së. Megjithatë, duket qartë që stafi akademik **[BM6]** por jo studentët **[BM5]** mbështetet për pjesëmarrjen e tyre në konferenca. UGJ-ja ka nënshkruar marrëveshje të shumta me IAL brenda dhe jashtë vendit për rritjen e bashkëpunimit, organizimin e eventeve të përbashkëta dhe iniciativave të ndryshme për kërkimin shkencor, të cilat janë aktualisht në zbatim. **[C.13; C.14]**, **(Kapitulli II Standardi I.3).**

⁹ <http://uogj.edu.al/githe-aktivitetet/>

¹⁰ <https://www.facebook.com/Universiteti-Eqrem-Cabej-Gjirokastrë-Faqja-Zyrtare>.

- 4.8 Fushat kryesore kërkimore përcaktohen nga grupet kërkimore dhe propozimet bëhen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit **[A.E1.1; A.E1.5]**. Fushat e hulumtimit propozohen nga njësitë bazë dhe kryesore si: Metodologjia e mësimdhënies dhe të nxënies, Zhvillimi historik dhe gjuhësor; Biodiversiteti dhe mjedisi, zhvillimet demografike, turizmi etj. Universiteti nxit diskutimet shkencore në fushat kryesore kërkimore, përmes organizimit të ditëve akademike, leksioneve të hapura dhe seminareve, ku personeli akademik angazhohet duke diskutuar rreth ideve dhe arritjeve shkencore, por këto aktivitete nuk janë të dokumentuara si dhe nuk ka pedagogë të huaj që mund të prezantojnë metoda të reja kërkimi **[BM4]**. Ka pasur raste kur pedagogë të huaj kanë dhënë leksione në disa departamente, siç është rasti në degën e histori-geografisë **[BM5]**. *(Kapitulli II Standardi I.4).*
- 4.9 Ndonëse UGJ ka ngritur dhe e ka përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën në mbështetje dhe funksion të veprimtarisë kërkimore-shkencore, kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për kërkimin shkencor dhe për të gjeneruar të ardhura **[BM9]**. UGJ ofron laboratorë, ambiente bibliotekare etj. për përmbushjen e disa përparësive. Që të zhvillojë strategjinë e institucionit, UGJ-ja rekruton staf akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, bazuar në rregulloren për rekrutimin e personelit akademik **[A.E2.1; BM9]**. Në përgjithësi, UGJ-ja u jep përparësi kandidatëve që kanë grada apo tituj akademikë, veçanërisht atyre që i kanë marrë këta tituj në universitete të huaja të njohura. Është deklaruar se **[RVV, fq. 48]** se përparësitë kërkimore përfshirë forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e kërkimit, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit të studiuesve dhe biznesit, etj., janë në përputhje me qëllimet institucionale, që rrjedhin nga politikat e zhvillimit të institucionit. Megjithatë, më tepër angazhime nevojiten në aspektin e kërkimit. *(Kapitulli II Standardi I.5).*
- 4.10 Është e qartë se një nga pikat kyçe të strategjisë së zhvillimit të UGJ-së është kërkimi **[A.E1.43]**. UGJ bashkëpunon me institucione kombëtare private dhe publike bazuar në memorandumë bashkëpunimi dhe kontrata, si me Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, Universitete të tjera të Republikës së Shqipërisë etj. **[C.12; C.13]**. Falë organizimit të konferencave janë bërë të mundura vizitat edhe të studiuesve të huaj. Këta të fundit kanë marrë pjesë në programe të ndryshme studimi në universitetin tonë si staf akademik i ftuar **[A.E1.38]**. Këto vizita kanë qenë më shumë të lidhura me aspektin e mësimdhënies, prandaj në të ardhmen, më shumë vëmendje i duhet dhënë kërkimit shkencor. UGJ zbaton një politikë të favorshme për mobilitetin e stafit akademik duke e inkurajuar atë të marrë pjesë në projekte kërkimore në institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit **[RVV, fq. 49]**. Në raport thuhet se anëtarët e stafit akademik të UGJ-së janë pedagogë apo anëtarë të grupeve kërkimore në Universitete jashtë vendit, por kjo nuk është e dokumentuar. Gjithashtu, UGJ ka mundësuar lejen administrative të pagueshme për profesorët që marrin pjesë në projekte afatshkurtra, krijimin e lehtësive për mobilitet, dhënien e një viti pushim një herë në shtatë vjet për profesorët që kryejnë kërkime shkencore afatgjata **[A.E1.37; A.E1.38]**. Për të mbështetur rritjen e cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e studimeve, UGJ fton stafin akademik të huaj të angazhohet në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura, si dhe të angazhohet me kohë të pjesshme. Megjithatë, numri i stafit akademik të huaj në mësimdhënie nuk është i kënaqshëm. Angazhimi i pedagogëve të jashtëm në vitet e fundit u ndikua veçanërisht si nga pandemia, ashtu edhe financat **[BM3]**. *(Kapitulli II Standardi I.6).*

- 4.11 Në bazë të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, UGJ është e detyruar të bëjë publike veprimtarinë kërkimore-shkencore si dhe rezultatet përkatëse. UGJ-ja boton "Buletinin shkencor" ndërkombëtar, kryesisht në vëllime, të cilat përmbajnë përmbledhje të referencave, kumtesave të mbajtura në kuadër të një veprimtarie shkencore (simpozium, konferencë, kongres etj.). Gjithashtu, ajo publikon rezultatet e veprimtarisë kërkimore në faqen zyrtare të institucionit etj., por, kjo nuk mjafton. Më shumë botime duhet të botohen në revista të huaja që të shoqërohen edhe me faktorë ndikimi. Megjithatë, një pjesë e stafit akademik në bashkëpunim me kolegë nga universitete të huaja kanë botuar punime në revista prestigjioze **[BM3]**. Gjithashtu, duhet menduar seriozisht që profesorët që botojnë punime në revista prestigjioze duhet të stimulohen, por kjo për momentin nuk po vihet në zbatim **[BM3]**. Për shkak të pandemisë dhe fondeve të pakta në dispozicion në dy vitet e fundit, shumë pak nga pjesëtarët e stafit akademik janë mbështetur për të paguar tarifën e botimeve **[BM3]**. **(Kapitulli II Standardi I.7).**
- 4.12 Puna kërkimore vlerësohet nga Njësitë Bazë, Njësitë kryesore të UGJ-së si dhe nga Senati Akademik. Gjithashtu, njësitë bazë organizojnë analiza periodike dhe vjetore për realizimin e detyrave të punës shkencore duke iu referuar planeve vjetore të secilit anëtar. Zëvendës rektori për Shkencën dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në bashkëpunim me njësitë bazë dhe kryesore, përgatit raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore universitare dhe ia paraqet për miratim Rektoratit. Në përfundim të vlerësimit, Rektorati ia dërgon Senatit Akademik. Në raport thuhet **[RVV, fq. 49]** se procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njërive bazë kryhet çdo katër vjet nga AKSHI, bazuar në kriteret bibliometrike, ndikimin e kërkimit shkencor, infrastrukturën, kapacitetin njerëzor dhe ndërkombëtarizimin. Vlerësimi në nivelin e njësisë bazë realizohet përmes një sistemi pikëzimi algoritmik, automatikisht nga platforma elektronike, Sistemi Informativ i Kërkimit Shkencor Shqiptar - SIKSHSH. Megjithatë, nuk ka një mekanizëm të qartë për vlerësimin e performancës kërkimore që duhet bërë përmes raporteve të departamenteve. Në fakt, kjo çështje nuk ishte e qartë as gjatë diskutimeve. **[BM6; BM8]**. Përveç kësaj, UGJ përdor për plagjiaturën një strukturë të brendshme, duke kërkuar në google, dokumente të ndryshme, por në të vërtetë, nuk ka një program specifik **[BM9]**. Ndonëse UGJ ka përcaktuar kriteret dhe standarde kundër plagjiaturës **[A.E1.25]**, nuk është e qartë se kur janë përgatitur këto kriteret dhe standarde dhe sa funksionale janë. Stafi i IT-së ka marrë pjesë në një trajnim të organizuar nga Ministria e Arsimit për plagjiaturën dhe është duke kontrolluar tezat e doktoraturës **[BM9]**. Të gjitha informacionet mbi rezultatet, produktet e të gjitha llojeve të veprimtarisë kërkimore në UGJ shpërndahen përmes platformës online me akses të hapur dhe përmes përditësimit të saj. UGJ gjithashtu publikon në mënyrë periodike dhe vë në dispozicion të stafit, studentëve, komunitetit të kërkimit dhe biznesit, Buletinin e saj Shkencor "Kërkimet Universitare", i cili vijon t'i përditësojë artikujt e buletinit me ISSN. Ky institucion organizon gjithashtu konferenca shkencore, seminare, bën promovime në rrjetin mediatik rajonal etj. **(Kapitulli II Standardet I.8).**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi:

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme në këtë Fushë Vlerësimi:

- Mungesën e projekteve kërkimore dhe pajisjeve laboratorike për të kryer kërkimet, të cilat mundësojnë publikimin e punimeve në revista të ndryshme me ndikim të konsiderueshëm. **(Kapitulli I Standardi II.4)**
- Buxheti për projektet e vogla kërkimore përdoret shumë pak. Përdoret kryesisht për aktivitetet e përbashkëta të departamenteve (pjesëmarrjen në konferenca, bashkëfinancimin e disa projekteve). Nuk ka një rregullore për shpërndarjen e duhur të fondeve për hulumtim. Universiteti duhet të gjejë mënyra më të mira për ndarjen e fondeve për kërkime. **(Kapitulli II Standardi I.1)**

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme për këtë Fushë Vlerësimi:

- Treguesit kryesorë të performancës duhet të përfshihen në RVV, duke filluar nga studentët e sapo regjistruar, numri i përgjithshëm i studentëve, numri i studentëve që braktisin shkollën, numri i diplomimeve, informacioni kryesor për buxhetin, lista e publikimeve, numri i publikimeve për profesor, lista e projekteve të financuara kombëtare dhe ndërkombëtare. **(Kapitulli I Standardi II.1)**
- Stafi duhet të reflektojë nga pyetësorët e studentëve dhe të përmirësojë performancën e tij, bazuar në kërkesat që studentët kanë paraqitur në pyetësorët e plotësuar. **(Kapitulli I Standardi II.3)**
- UGJ duhet të rrisë aplikimet për projekte kërkimore nga thirrjet kombëtare, si dhe duhet të rrisë numrin e projekteve kërkimore ndërkombëtare. **(Kapitulli II Standardi I.1)**
- Qendra Ndërdisciplinore për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor është në fazën fillestare të konsolidimit, por duhet të intensifikohet puna për fillimin e aktivitetit dhe stafi i ri të trajnohet për përdorimin e pajisjeve të përshtatshme. **(Kapitulli II Standardi II.6)**
- Në një të ardhme të afërt, UGJ duhet të organizojë për stafin seminare për të rritur ndërgjegjësimin ndaj plagjiaturës. **(Kapitulli I Standardi II.8)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi se veprimet e mëposhtme janë në proces e sipër:

- Hapat e ndërmarrë nga Universiteti për të akorduar rreth 3.5 milionë lekë për projekte të vogla kërkimore që mund të dorëzohen nga stafi i departamenteve. Megjithatë duhet të hartohet një rregullore për këto projekte dhe të informohen të gjithë studiuesit për këtë mundësi. **(Kapitulli II Standardi I.1)**
- Grupi i vlerësimit të jashtëm ka vërejtur se numri i trajnimeve të mësimdhënies nuk është i madh përkundër nevojave të mësuesve për të mësuar metoda të reja për mësimdhënien, ndonëse UGJ ka organizuar disa trajnime përmes projekteve të ndryshme. Gjithashtu, UGJ duhet të gjejë mekanizmin (të krijojë Qendrën e

Ekselencës) që përmes vlerësimit vjetor të stafit dhe aplikimit për grada akademike, t'i bëjë të detyrueshme këto trajnime në të ardhmen. **(Kapitulli I Standardi II.4)**

- UGJ po përpiqet të forcojë bashkëpunimin shkencor mes Qendrës Ndërdisciplinore për Kërkim dhe Zhvillim Shkencor dhe Departamenteve. **(Kapitulli I Standardi II.6)**

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Universiteti ndjek politikën e duhur për regjistrimin e studentëve të rinj dhe zbaton kriteret e propozuara nga departamentet dhe të miratuara nga Senati **[A.E1.59]**. Regjistrimi i studentëve bëhet duke respektuar kriteret, duke ofruar programe të përshtatshme dhe duke u dhënë të gjithë studentëve mundësinë e aplikimit në bazë të Statutit **[A.E1.1]** dhe Strategjisë së UGJ-së **[A.E1.33]**. UGJ i kushton një rëndësi të veçantë shkëmbimit të studentëve kryesisht bazuar në programin Erasmus **[A.E1.37]**. Kjo është e përfshirë edhe në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit **[A.E1.21]**. Çdo student që ka përfunduar ose ka vazhduar studimet e tij/saj në një vend tjetër ka mundur ta konvertojë diplomën e tij në bazë të statutit **[A.E1.1]**. Larmia e programeve lehtësojnë transferimin e studimeve dhe ndjekjen e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë **[A.E1.33]**. UGJ së bashku me Shërbimin Studentor organizon çdo vit ditë të hapura me maurantët për t'i informuar ata mbi programet si dhe lehtësitë që ofron institucioni **[A.E2.13]**. Stafi akademik përcakton ditët e informimit për maurantët, ngre grupet e këshillave dhe prezanton programet në zyrat lokale, përfshirë edhe shpërndarjen e broshurave në shkolla. Në disa ditë të tjera, dyert e UGJ-së hapen dhe qëndrojnë të hapura për rreth dy javë në mënyrë që maurantët të njihen me infrastrukturën **[BM7]**. Studentët e mundshëm informohen edhe përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe përfaqësuesve të stafit akademik të njëjësive bazë **[A.E2.12]**. Përveç kësaj, shpërndahen edhe broshura informative me programet përkatëse të studimit **[A.E2.13]**. Gjithashtu, Zyra e Karrierës ka organizuar me studentët disa seminare mbi tregun e punës dhe kërkesat e tij **[BM9]**. Traditë e UGJ-së është të organizojë takime mikpritëse me studentë që sapa kanë fituar këtë status për t'i orientuar ata jo vetëm për programet, por për të gjitha shërbimet që ofron UGJ. Gjithashtu, në Rregullore **[A.E1.5]** theksohet rëndësia e këshillimit akademik si rol dhe mision i udhëheqjes profesionale dhe akademike. Pas regjistrimit, studentët kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet përfaqësuese, të marrin pjesë në seminare, trajnime, projekte, në biseda të hapura me stafin akademik, në dhënien e mendimit për çdo vendim që ndikon në statusin e tyre si student, si dhe mund të marrin pjesë në veprimtari të tjera të organizuara nga UGJ **[RVV, fq. 52]**, Gjithsesi, kjo nuk u shpjegua qartë nga përfaqësuesi i studentëve në senatin akademik **[BM2]**. Duket se studentët angazhohen pjesërisht në disa prej këtyre veprimtarive **[BM5]**.

UGJ komunikon vazhdimisht me Drejtorinë Arsimore Rajonale për informimin e maurantëve, por edhe për kryerjen e praktikës profesionale për programet e mësimdhënies **[A.E4.24]**. Për t'u ofruar sa më shumë lehtësi studentëve, UGJ ka ngritur struktura të posaçme për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj dhe këto struktura janë të vendosura në rektorat. Për sa i përket çdo programi studimi, sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve, të cilët janë të pajisur me ID si dhe orientohen në mjediset e tjera që ofrohen **[A.E5.1]**. Pedagogët janë të detyruar të respektojnë një orar të caktuar konsultimi me studentët, për të dhënë informacion apo asistencë, jo vetëm për lëndën përkatëse, por edhe për programin apo shërbimet e tjera që ofron institucioni **[A.E4.1]**. Kjo është edhe e konfirmuar **[BM3]**, por nuk ka ende studentë që kërkojnë asistencë javore. Gjithashtu nuk ka informacion lidhur mbi kohëzgjatjen e konsultimit dhe rezultatin përfundimtar të tij për sa i përket ecurisë së studentëve. Strategjia e Ndërkombëtarizimit **[A.E1.21]** ka ardhur si rezultat i

orientimit të UGJ-së drejt një qasjeje të re; hapjes së institucionit për të lehtësuar përthithjen dhe integrimin e studentëve të huaj përmes marrëveshjeve ndër-institucionale. Gjithsesi, strategjia u miratua në shtator të vitit 2020 dhe aktualisht është vështirë të vlerësohet ndikimi që ka pasur kjo strategji. Kjo është arritur kryesisht përmes marrëveshjeve të UGJ-së në kuadër të programeve Erasmus **[A.E1.36]** dhe kritereve të pranimit të studentëve, përfshirë miratimin e kuotave për pranimin e studentëve të huaj **[A.E3.40]**. Stafi akademik i UGJ-së është i detyruar të jetë në dispozicion të studentëve, çdo javë, për të zhvilluar konsultime në zyrën e tyre për një numër të arsyeshëm orësh. **[A.E5.3]**. Studentët informohen për oraret ose nga sekretaria mësimore ose ato u komunikohen gjatë kursit. Për sa i përket raportit pedagog-student në vitet e fundit nuk ka ndryshime domethënëse, por gjithsesi, ka ndryshime ndërmjet fakulteteve **[A.E5.2]**. *(Kapitulli I Standardi III.1).*

5.2 Pranimi i studentëve bëhet nga dy struktura kryesore të vendosura në Rektorat dhe në njësitë bazë **[RVV, fq. 53]**. Edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni luan një rol të rëndësishëm, sepse i këshillon studentët për regjistrimin, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i statusit të studentit, rregulloret dhe statutet e universitetit, lëndët me zgjedhje, aspektet financiare dhe veprimtaritë shkencore e kulturore. Studentët vihen në dijeni për operimin e Zyrës së Alumni, ku kërkojnë ndihmë sipas nevojës, por nuk zhvillojnë takime të rregullta **[BM5]**. Gjithashtu, zyra e IT-së është përgjegjëse për krijimin, menaxhimin dhe administrimin e llogarisë personale të çdo studenti, përmes së cilës studenti informohet për procesin mësimor. Stafi, studentët dhe palët e treta, që janë të interesuar të kenë informacione rreth UGJ-së, i gjejnë komunikimet dhe informacionet përkatëse në faqen zyrtare të internetit www.uoqi.edu.al, (informacioni, dokumentet, veprimtaritë, etj.). Nuk mungojnë as mediat sociale si një mjet i ri komunikimi në kohët e fundit; adresat e përdorura zakonisht janë ato në Facebook dhe Instagram. Nisur nga situata e krijuar nga pandemia, komunikimi ka filluar të ndryshojë. Në fillim të pandemisë u hasën shumë vështirësi. Fillimisht u përdor platforma Google classroom, por këtë vit nisi të përdorej platforma Teams, e cila e ka lehtësuar shumë komunikimin, veçanërisht mësimin online **[BM2]**. Nga ana tjetër, UGJ përdor mjete komunikimi me shkrim si dokumentet e shkruara për palët që kërkojnë informacione zyrtare **[A.E2.39]**. Për komunikim të brendshëm përdoret komunikimi virtual me email, njoftimet dhe publikimet në “Këndin e Njoftimeve” kryesisht për studentët, si faqja zyrtare të UGJ-së www.uoqi.edu.al, si dhe rrjeti i brendshëm telefonik **[A.E2.28]**. Komunikimi i stafit në UGJ rregullohet në përputhje me rregulloren **[A.E1.5]**. Komunikimet dhe njoftimet e çdo lloji drejtuar stafit akademik dhe personelit të institucionit bëhen përmes adresës elektronike zyrtare, si dhe përmes publikimit në faqen zyrtare të internetit www.uoqi.edu.al. **[A.E2.28]**. Dosja personale dhe të dhënat personale të çdo studenti administrohen nga sekretaria mësimore në përputhje me Rregulloren e UGJ-së **[A.E1.5]**. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për administrimin e të dhënave **[E2.55]** duke marrë parasysh detyrimin për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale **[A.E2.53]** dhe regjistrat elektronikë, përfshirë adresën e postës elektronike të secilit student për komunikim dhe numrin e telefonit **[A.E2.55]**. *(Kapitulli I Standardi III.2).*

5.3 UGJ synon t'u japë përparësi studentëve sipas rendit për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të të dhënave për regjistrimin e studentëve për dy ciklet e studimit **[A.E5.17]**. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni i angazhon studentët në trajnime dhe u jep

informacione si të përgatiten për tregun e punës, të përgatisin CV-të e tyre, të përgatiten për panairë pune dhe mundësi të ndryshme punësimi, programe studimi dhe mundësi për të kaluar nga një program studimi në tjetrin brenda ose jashtë UGJ-së **[RVV, fq. 54]**. Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni mbështet dhe ofron këshillim për aplikimet, për vazhdimin e ciklit të studimeve apo cikleve të tjera të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit **[A.E5.24]**. Programet e studimit në UGJ janë riorganizuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni përgatit dhe shpërndan broshura informative mbi programet e studimit të ofruara nga UGJ **[A.E2.11]**, zhvillon aktivitete të ndryshme informuese me studentët dhe siguron paraprakisht materialet e nevojshme informative **[A.E2.12; A.E2.13]**. Megjithatë, duhet të hartohet rregullorja për Alumni, në mënyrë që të forcohet bashkëpunimi me Alumni përmes takimeve zyrtare të organizuara nga sektori i Zyrës së Këshillimit për Karrierën dhe Alumni, Aktivitetet Sportive dhe Kulturore. UGJ parashikon mundësinë e ndryshimit të programit të studimit përmes procedurës së transferimit brenda dhe jashtë institucionit me kusht që transferimi të bëhet në programe studimi përkatëse në përputhje me Statutin dhe Rregulloren **[A.E1.1; A.E1.5]**. Procedura e transferimit kryhet përmes Komisionit *ad hoc* të ngritur në njësitë bazë kryesore, të cilat kontrollojnë programin e studimit nga i cili hiqet dorë dhe programin në të cilin studenti kërkon të aplikojë. Lista e studentëve që kërkojnë ndryshimin e programit i dorëzohet Rektoratit dhe duhet të miratohet nga Rektori **[A.E3.41]**. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni i udhëzon dhe këshillon studentët gjatë të gjitha cikleve të studimit, si dhe gjatë kalimit nga cikli i parë i studimeve në ciklin e dytë dhe të tretë **[A.E5.24]**, si dhe për futjen e tyre në tregun e punës. Madje, ajo i ndjek ata edhe pas diplomimit **[A.E5.23]**. **(Kapitulli I Standardi III.3).**

